


**VLERSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR URBAN TE PRISHTINES
2013-2023**



Gusht, 2013

Përmbajtja

1 HYRJE .

1.1 Te dhënat Historike

1.2. Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

1.3. Baza e Planit zhvillimor Urban të Prishtinës

1.4. Objektivat e VSM për Planin zhvillimor Urban të Prishtinës

2. Legjislacioni Mjedisor dhe Institucionet

2.1. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

2.2. Ligji për Planifikim Hapësinor

2.3. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM),

2.4. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM),

2.5. Ligji për vetëqeverisjen lokale

2.6. Konventat Nderkombetare Mjedisore

3. Direktivat e BE-s

3.1 Direktiva e BE-së, VSM

3.2 Direktivat e tjera të BE-së

3.3 Strategjia 2020 e BE-së

3.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

3.5 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

3.6. Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

3.7. Organizatat Jo-Qeveritare

3.8. Strategjia për zhvillim Hapësinor të Prishtinës

4. Procesi dhe Metodologjia e VSM-së

4.1. Metodologjia

4.2. Literatura dhe Burime të Shkruara Informimi për VSM

4.3. Takime dhe Biseda me Perfaqësues të Institucioneve

4.4. Struktura e Raporti Përfundimtar të VSM-se

4.5. Nevoja për Plan Rregullues

4.6. Objektivat e Planit

4.7. Historiku i Planeve dhe Analizë e Situatës Ekzistuese

4.8. Problematika të Zhvillimit dhe Planifikimit Urban në Prishtinë

4.9. Zhvillimi Urban

5. Rrjeti Rrugor

5.1. Trafiku dhe Transporti

5.2. Lidhja në mes kryeqytetit dhe rrjetit nacional dhe internacional (transporti i pasagjerëve)

5.3. Projektioni i Popullatës

5.4. Faktorët

5.5. Skenarët e projeksioneve

5.6. Projektionet sipas Njësive Urbanistike

5.7. Konsiderata mbi Alternativat e Shpërndarjes Hapësinore

6. Kushtet Mjedisore të Prishtinës

6.1 Aspekte Kryesore të Gjendjes Aktuale Mjedisore

6.2. Problemet e Identifikuara mjedisore

6.3. Popullsia dhe Shëndeti

6.4. Shëndeti

6.5. Çështje Ekzistuese Mjedisore të Lidhura me Popullsine dhe Shëndetin

7. Mjedi Fizik

7.1. Çështje Mjedisore që Lidhen me Mjedisin Fizik

7.2. Zonimi i Prishtinës

7.3. Natyra dhe Biodiversiteti

7.4. Speciet e zbuluara

7.5. Çështje mjedisore të lidhura me Biodiversitetin

7.6. Shfrytëzimi i Tokës

7.7. Çështje Mjedisore që Lidhen me Përdorimin e Tokës

7.8. Mjedi i Ndërtuar dhe Kultura

7.9. Cilësia e Ajrit

8. Burimet Ujore

8.1. Burimet Ujore dhe Furnizimi me Ujë

8.2. Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm

8.3. Menaxhimi i Mbeturinave

8.4. Furnizimi me Energji

8.5. Problemet Energjetike me të cilat përballët Prishtina

8.6. Aktivitetet Ekonomike dhe Sociale

8.7. Analiza SWOT

9. Krahasimi i Alternativave

9.1. Alternativa sipas Zgjerimit të "Planit të Qendrës"

9.2. Alternativa sipas Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës

9.3. Parime, Objektiva dhe Kriteret që kufizojnë zhvillimin urban

9.4. Parime të Përgjithshme për Planifikim Hapësinor

9.5. Kriteret e forta Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Urban

9.6. Kriteret Peisazhike

10. Ndikimet e Mundshme mjedisore dhe masat për zbutjen e tyre

10.1. Plani dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit në Prishtinë

10.2. Analiza e Plotë e Ndikimit në Mjedi të PZHUP

10.3. Masat e Nevojshme në PZHUP për Mbrojtjen e Mjedisit

11. MONITORIMI

12. PERFUNDIME

13. LITERATURA

14. Shtojca 1: Lista e Shkurtimeve

1 HYRJE .

1.1. Historiku

Qyteti i Prishtinës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 7768.7ha. Prishtina ka shtrirje në gjerësi gjeografike prej 42°40'00'' dhe gjatësi prej 21°20'15'', me pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik. Relievin e Prishtinës e përbëjnë terrenet e ngritura me lartësi mbidre prej 535-730m.

Qyteti rrethohet prej shpatijeve në të trija anët, duke krijuar një situatë topografike amfiteatrale. Në veri dhe në lindje, pylli i Gërmisë arrin lartësinë prej 1100 m. Në perëndim, Prishtina kufizohet me shpatijet e Arbërisë (ish-Dragodanit), në veri me kodrën e Pozderkës, në lindje me pyllin e Gërmisë duke vazhduar më tej me vargun e bjeshkës së Butovcit (malet e Prugovcit dhe Grashticës), dhe në jug e juglindje me vargun e maleve të Veternikut dhe me vendbanimin e Matit.

Në Veri qyteti kufizohet me zonat kadastrale Bërnice e epërme, Bërnice e poshtme dhe Llukar;

Në Lindje qyteti kufizohet me z. kadastrale Makoc, Mramor, Novosellë;

Në Jug qyteti kufizohet me z. kadastrale Graçanicë;

Në Perëndim qyteti kufizohet me z. kadastrale të Fushë Kosovës dhe Shkabajve.



Harta 1 Kufinjet e zones urbane te Prishtinës

Gjurmët e banimit në rajonin më të gjerë të Prishtinës mund të përcillen që nga vendbanimet parahistorike për të cilat dëshmojnë shumë lokalitete arkeologjike. Vendbanimi autokton, 7 km larg Prishtinës se sotme, në kohën e sundimit të Trajanit (98-

117 p.e.r.), ngritet në rangun e municipiumit dhe merr emrin Ulpiana për nder të perandorit.

Prishtina, si vendbanim përmendet për herë të parë në shek. XIII. Merita të veçanta për zhvillimin e tregtisë në periudhën XIV e XV e kanë dubrovnikasit, të cilët në Prishtinë e formuan edhe koloninë e parë, më të madhen prej katër kolonive që kishin në atë kohë në Ballkan. Në këtë kohë, Prishtina ishte qendër e fuqishme tregtare dhe financiare, e cila tërhiqte tregtarët nga Gjenova, Verona, Mantova dhe Firenca.

Në vitet 1486/87 Prishtina kishte 392 shtëpi në 10 lagje, me "nahinë" prej 51 fshatrave.

Më 1569/70 Prishtina kishte 629 shtëpi në 29 lagje,

Më 1660 Prishtina kishte 2060 shtëpi,

Më 1685 kishte 3000 shtëpi,

Më 1689 - 4000 shtëpi;

Më 1811, Prishtina kishte 12000 banorë.

Më 1991, Prishtina vlerësohet me 150.000 banorë ndërsa

Më 1999, Prishtina vlerësohet me 338.000 banorë.

Më 2000, sipas OSCE komuna e Prishtinës vlerësohet të ketë pasur 545,477 banorë.

Më 2003, Prishtina vlerësohet të ketë qenë prej 315.000 – 420.000.

Më 2011, vlerësohet se komuna e Prishtinës ka 198 897 banorë, ndërsa qyteti i Prishtinës ka 149 250 Banorë.

Nëpër qytetin e Prishtinës kanë kaluar rrugë të rëndësishme që vinin nga Bosna, rruga Naissus-Lissus, nga Scupi etj. Prishtina përmendet nga kontaktet e para raguzane në fund të viteve të shtatëdhj të shekullit XIII, përderisa gjatë mesjetës u bë seli e rëndësishme. Para betejës së Kosovës ishte kryeqytet i provinces, ndërsa në vitin 1426 Prishtina kishte dhe konsullatën dubrovnikase. Në shekujt XIV dhe XV, vepronin një numër i madh i tregtarëve dubrovnikas, të cilët bënë tregti me qytetet më të zhvilluara në rajon. Prishtina sipas Shtjefën Gaspërit 1671, ishte një ndër qytetet kryesore të Kosovës, qendër administrative e xehrisë së krahinës xehre të Artanës (Novobërdës). Në vitin 1689 e dobësuar nga lufta Austro-turke, ishte qendër e shtabit të gjeneralit austriak Pikolominit, përderisa që më 1812, Prishtina kishte dy panairë, të vjeshtës dhe të pranverës, ku merrnin pjesë shumë tregtarë nga lindja dhe perëndimi. Që në vitin 1892, periudhë e reformave të perandorisë otomane, komisioni i ri i reformave përbëhej nga persona të njohur dhe të respektuar me përkatësi shqiptare, si ishte dhe Danish Beu i cili më vonë u bë dhe ministër i punëve të brendshme të Perandorisë.

Prishtina u bë qendër administrative e Kosovës në vitin 1947. Në Prishtinë, pas Luftës së Dytë Botërore, filloi të ndërtohet infrastruktura institucionale dhe urbane, me moton e ndërtimit të një qyteti me pamje urbane. Me planin urban të qytetit të vitit 1953, u rrënuan lagje të tëra së bashku me çarshinë e vjetër,

duke e shkatërruar arkitekturën popullore shqiptare të periudhës turke. Prishtina, pas Luftës së Dytë Botërore, e fitoi funksionin e qytetit të rëndësishëm ekonomik dhe administrativo-politik, që i krijuan bazë materiale solide. Madhësia e qytetit matej me shkallën e inkuadrimit, numrin e kuadrove, specialistëve, shkencëtarëve, politikanëve dhe profesioneve të lira intelektuale

Pas vitit 1999 zhvillimet në qytetin e Prishtinës ndikuan në mënyrë qenësore në strukturën urbane. Mbi 70% e strukturës urbane u transformua, si pasojë e mungesës së fuqizimit të ligjeve dhe të standardeve të nevojshme të planifikimit dhe ndërtimit.

1.2.Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë njerëzore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të “parandalimit” sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM).

Procesi i VSM-se është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive

1.3.Baza e Planit zhvillimor Urban të Prishtinës

Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Prishtinës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, kualitetit të jetës, mjedis të shëndoshë

mjedisor dhe social, mbrojtë resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore, për më shumë ruajtje dhe kultivim identitetin urban të saj.

Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, porse dhe parimet dhe konventat ndërkombëtare lidhur me shumë çështje sfiduese urbane:

PZHUP bazohet në:

- Ligjin për Planifikim Hapësinor 2003/14
- Ligj për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14
- LIGJI NR. 04/L-040 PËR RREGULLIMIN E TOKËS
- LIGJI NR. 04/L-013 PËR KADASTËR
- LIGJI NR. 04/L-016 PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË
- LIGJI NR. 03/L-160 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA
- LIGJI NR. 03/L-164 PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË BANIMIT
- LIGJI NR. 03/L-168 PËR TURIZMIN DHE SHËRBIMET TURISTIKE
- LIGJI NR. 03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
- LIGJI NR. 03/L-024 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS
- LIGJI Nr. 03/L-230 PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR

Parimet në të cilat bazohet “Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2013 – 2023”, dalin nga korniza ligjore në Kosovë, legjislacioni Evropian-ESDP-së apo Programit Evropian për Zhvillime Hapësinore. Me këtë dokument vërehen në jetë politikat e zhvillimeve hapësinore në territorin e BE-së duke pasur parasysh parimet fundamentale në zhvillim të një hapësire:

Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës 2013-2023, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, krijon kushte për sigurimin e lokacioneve për investimet kapitale të zhvillimit ekonomik, përmirësimin e shërbimeve të infrastrukturës, mbrojtjes së trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Korniza e procesit të planifikimit hapësinor, parasheh proces të gjerë të pjesëmarrjes. Sipas kësaj kornize procesi është i ndarë në 4 faza:

- Ku jemi ? Sfidat e zhvillimit hapësinor;
- Ku dëshirojmë të shkojmë ? Vizioni dhe caqet strategjike;
- Si të shkojmë ? Strategjia e zhvillimit hapësinor; dhe
- Si të bindemi se kemi arritur? Monitorimi dhe evoluimi

Në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor, Plani Hapësinor është plan multisektoral, i cili merr parasysh raportet dhe strategjitë e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë. Involvimi i të gjithë pjesëmarrësve, të cilët mund të kenë ndikim ose të jenë të ndikuar nga Plani është esenciale për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Hapësinor.

Më poshtë është skema e përgjithshme e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013- 2023 dhe ndërlidhja e tij me dokumentet tjera zhvillimore të cilat i nxjerrë Qeveria e Kosovës.

1.4. Objektivat e VSM për Planin zhvillimor Urban të Prishtinës

Objektivi kryesor i VSM-së, është orientimi i Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij. Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të PZHU, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre. VSM analizon disa skenarë. Skenari "0", pra i "të mos bërit asgjë" në Prishtinë do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm. Në vend të kësaj, VSM-ja synon të orientojë planin për realizimin e objektivave të tij në një mënyrë të qëndrueshme.

Për Planin Zhvillimor të Prishtinës, vlerësimi merret veçanërisht me ndikimin mjedisor që mund të ketë zbatimi i planit. Siç u tha në paragrafin më sipër, skenari "0" nuk është zgjidhja e duhur, pasi gjendja aktuale mjedisore në Prishtinën e zgjeruar është jashtëzakonisht i dobët po ti referohemi standardeve të BE-se, dhe do të përkeqësohet edhe më shumë nëse vazhdon rritja e paplanifikuar në këtë mënyrë.

Veçanërisht për PZHUP, ky vlerësim shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të:

Mjedisit urban në tërësi – përdorimit të tokës, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, hot-spoteve potenciale të ndotjes, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore;

Mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar – monumentet e godinat arkeologjike, kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat peizazhistike, qendrat historike të qytetit;

Veprimtarive ekonomike dhe shoqërore – të tilla si tregtia, industria, shëndeti dhe arsimi, si dhe ndikimi që këto kanë mbi mjedisin.

Infrastrukturës dhe sigurimit të shërbimeve – siguri (burimor) i ujit, energjisë dhe telekomunikacioneve; menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme; qarkullimi dhe lëvizshmëria në rrugë dhe transport; lëvizshmëria alternative;

2. LEGJISLACIONI MJEDISOR DHE INSTITUCIONET

2.1.Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit , rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar;

Përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen eshëndetit të njeriut;

Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtritshme dhe të papërtritshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre;

Bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;

Bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;

Nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit.

Të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, ujë dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme;

Të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe Të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Parimet kryesore, të cilat rregullojnë legjislacionin mjedisor në Kosovë, janë të përafërta me ato të Bashkimit Evropian.

-Zhvillimi i qëndrueshëm;

-Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

-Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore

-Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit

-Parimi i përafrimit të integruar

-Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

-Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

-Ndotesi paguan;

-Ndergjegjesimi publikut dhe pjesëmarrja në vendim marrje

Lidhur me Planet Zhvillimore Komunale, Urbane dhe Planet Rregulluese Urbanë duke ju referuar dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe atij të mjedisit, kerkohet që në hartimin e planve të merret parasysh ndjeshmëria e mjedisit, kapaciteti bartës i saj, lidhja dhe harmonia e vlerave të peizazhit

natyror, lidhja ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme, trashëgimia kulturore, si dhe tërësia e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese në mjedis dhe atyre të planifikuara, ku bëhet fjalë ekskluzivisht për VSM, theksohet ndër të tjera se këtij vlerësimi i nënshtohen projektet e planifikimit të territorit, si dhe planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor;

Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit, është përgjithësisht përafrim me direktivat dhe standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Të cilat direktiva kërkojnë

“Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;

“Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;

“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve;

“Për mbrojtjen e biodiversitetit”;

“Për trajtimin e ujërave të ndotur”;

“Per substancat dhe preparatet kimike”;

“Per administrimin e zhurmave ne mjedis”;

“Per zonat e mbrojtju

2.2. Ligji për Planifikim Hapësinor

Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji nr. 03/L-106, si qëllim kryesor i këtij ligji është rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban .. Sipas këtij akti ligjor, planifikimi hapësinor duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, po ashtu duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet . Në mesin e parimeve është po ashtu edhe përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur.

Parashikohet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar Komisionin e Ekspertëve të Planifikimit (në nivelin lokal) dhe Këshillin për Planifikim Hapësinor (në nivel kombëtar). Në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Posaçme, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet për Zhvillim Urban, Planet Rregulluese Urbane. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 5 vjetëve dhe ta përfshijë një plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Po ashtu duhet ta përfshijë një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve shoqëro-ekonomike dhe mjedisore. Raporti i VSM, identifikon që institucioni kryesor që është përgjegjës për zbatimin e ligjit të sipërpërmendur në nivel kombëtar është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) e cila në pajtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimin hapësinor. MMPH është po ashtu përgjegjëse për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin . Në kuadër të sistemit të Kosovës të planifikimit në dy nivele, niveli i qeverisjes lokale ka rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve dhe të kërkesave planifikuese të përcaktuara nga Ligji për Planifikimin Hapësinor. Komunitatet e Kosovës luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e komuniteteve të tyre, duke krijuar pasuri dhe duke imponuar identitetin lokal. Shoqëria duhet të ketë udhëheqje të fuqishme që i bashkon të gjitha palët e interesuar relevante, përfaqësuesit e komunitetit dhe të biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e strategjisë duke u bazuar në një vizion të përgjithshëm. Ky është njëri nga aktivitetet kryesore që pritet ta kryejnë komunitatet.

“Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;

“Per taksen e karbonit e te ambalazhit plastik”;

Krahas hartimit te ligjeve, vitet e fundit, eshte punuar per plotesimin me akte nenligjore te ligjeve te miratuar, me qellim qe te lehtesohet zbatimi praktik i tyre: Drejtim tjetër te rendesishem ne plotesimin e kuadrit ligjor, kane perbere hartimi dhe miratimi i nje sere regulloresh dhe udhezimesh te karakterit organizativ apo teknik dhe qe synojne mire funksionimin e institucioneve perkatese dhe bashkerendimin institucional te veprimtarive per mbrojtien e mjedisit. Hartimi dhe miratimi i ketyre akteve, zgjeron dhe forcon bazen ligjore per mbrojtjen dhe menaxhimin e qendrueshem te mjedisit.

2.3. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM),

Ky ligj ka për qëllim: Parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Ky ligj gjithashtu përcakton rregullimin e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor, dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë ofruar dhe janë marrë parasysh. (Neni 1)

Dhe si Fushëveprim i këtij ligji janë Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis -VNM, identifikimi, përshkruarja dhe vlerësimi në mënyrë të duhur i rrethanave të secilit rast individual, efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndonjë projekti në:

Njeriun, botën bimore dhe shtazore;

Tokë, ujë, ajër, klimë dhe peisazh;

Të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore;

Ndikimet e ndërsjella të elementeve të cekura më lartë. (Neni 3)

Ligji i VNM është një nga aktet ligjore me të rendesishme për parandalimin e ndotjes apo dëmtimit të mjedisit nga aktivitetet humane. Ky ligj kërkon berjen e një vlerësimi të përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis.

2.4. Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM),

Qëllimi i këtij ligji është që: Me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ky ligj gjithashtu përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, (në tekstin e mëtutjeshëm VSM) përmes integritetit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

(Neni 1) Fushëveprimi

VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.

Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit të mbeturinave, menaxhimit të ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.

Për planet dhe programet nga paragrafi 1. i këtij neni, me të cilat parashihet edhe shfrytëzimi i sipërfaqeve të vogla në nivel lokal ose në rastet e modifikimeve të vogla të planeve ose programeve, të cilat nuk kërkojnë procedurë të rregullt për miratim si dhe për planet ose programet të cilat nuk janë të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, vendimin për VSM e merr autoriteti përgjegjës i planit ose programit, nëse sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj, vërtetohet se ekziston mundësia e ndikimit të theksuar në mjedis. VSM nuk bëhet për planet dhe programet të cilat i dedikohen mbrojtjes së vendit, evitimit të pasojave nga katastrofat natyrore dhe për planet financiare dhe buxhetore.(Neni 3)

2.5. Ligji për vetëqeverisjen lokale

Ky ligj (Ligji Nr. 03/L-040) themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. E drejta për :

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të ligjit për vetëqeverisjen lokale

Në faktë hartimi i VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës duhet merrë në konsideratë

edhe ligjet tjera që kanë ndikim ose rregullojnë fushat e ndryshme të mbuluara nga Plani Zhvillimor

Komunal siç janë:

Ligjin për mbrojtjen e natyres (ligji nr. 03/l-233)

Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (ligji nr. 03/l-160)

Për mbrojtjen nga zhurma (ligji nr. 02/l-102)

Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (ligji nr. 04/-l-027)

Për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare (ligji nr. 03/l-104)

Ligji për ujërat e Kosovës

Ligji për mbeturina (2011/04-L-060)

Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural (2009/03-L-98)

Ligji për Pesticidet 2003/20

Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës (2004/29)

Ligji për Rrugët (2003/11)

Ligji për tokat bujqësore (2005/02-L26)

Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)

Edhe disa ligje të tjera:

2. 6. Konventat Nderkombetare Mjedisore

Ne kontekstin e këtij raporti, disa nga konventat mjedisore të cilat duhet marrë parasysh gjatë hartimit të VMS janë renditur me poshte.

Konventa e Bernes; “Per ruajtien e flores dhe faunes se eger dhe mjedisit natyror te Europes”

Konventa e Bazelit; "Per kontrollin e levizjeve nderkufitare te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre".

Konventa e Vjenes; "Per Mbrojtjen e Shtreses se Ozonit" dhe Protokolli i Montrealit "Per substancat qe hollojne shtresen e ozonit".

Konventa e Aarhus-it; "Per te drejten e publikut per te pasur informacion, per te marre pjese ne vendim-marrje dhe per t'iu drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit".

Konventa e Espoo-s "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ne Kontekst Nderkufitar".

Konventa Kuader e Kombeve te Bashkuara Per ndryshimet klimatike,

Konventa e Kombeve te Bashkuara per Biodiversitetin,

Konventa per ruajtjen e flores dhe faunes se eger te mjedisit natyror te Europes

Konventa per mbrojtjen e specieve shtegetuese te kafsheve te egra

Konventa per ndotjen atmosferike ne distanca te medha

Konventa per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekstin nderkufitar

Konventa per rivleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekstin nderkufitar

Konventa e Bazelit mbi kontrollin e levizjeve nderkufitare

Konventa e mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre,

Konventa e Stokholmit; "Mbi ndotesit organike te qendrueshem",

3. DIREKTIVAT E BE-s

3.1 Direktiva e BE-së, VSM

Direktiva e Këshillit 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis (Direktiva VSM) u aprovua më 27.06.2001. Direktiva VSM vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Direktiva VSM nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian ..., 2001) thotë që 'planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar,) rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative'.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet të cilat janë të shënuara në Direktivë si vijon: 'përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM); janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve'.

Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmblihet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativat e arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e

paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

3.2 Direktivat e tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë. Sipas Marsden (2008) 'VSM ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti meqë vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve (dhe të programeve) por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme'.

3.3 Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha¹ është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor meqë bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioriteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë 'zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës'. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve* dhe *Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën*, *Unioni i përtëritjeve*, *Rinia në lëvizje*, *Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune* dhe *Platforma evropiane kundër varfërisë* do të mundeshin po ashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji po ashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjërat e përtëritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

3.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB ka një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t'i sigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit

rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në Nju Jork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- `integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthimi mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetët e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra ´.

3.5 Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Objektivi i Konventes Me qëllim që të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotme të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij, çdo Palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen ..., 1998) Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon: të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyeën pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;

të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim; të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.´

3.6.Konventa Espoo dhe Protokoli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi Mjedisor, 1991) përcakton 'obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit'. Po ashtu i formulon 'obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve'. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008), 'Protokolli i Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008)'. Protokolli është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokolli po ashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokolli kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

3.7. Organizatat Jo-Qeveritare

Organizatat mjedisore në Prishtinë por edhe nëpër komunat tjera të Kosovës janë krijuar kryesisht pas luftës, kur u vendosen edhe bazat e në demokracië dhe u krijuan kushtet e favorshme për formimin dhe zgjerimin e organizatave jo qeveritare (OJQ). Tashmë në Kosovë ka një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve mjedisore, por vetëm një pjesë e tyre janë aktive.

Organizatat mjedisore të Kosovës por edhe ndërkombëtare që operojnë në Kosovë kanë ndermarre aktivitete sensibilizuese dhe ndergjegjesuese për mbrojtjen e mjedisit ndërsa të cilat mund të përmendim fushat si: Mbrojtja e biodiversitetit, vlerësim i habitateve, depozitimi i mbetjeve të ngurta, studim i problemeve të lidhura me ndotjen rurale dhe urbane, etj. Përfshirje e komunitetit në vendim marrje, diskutime në tryeza të rrumbullaketa, nënshkrimin e vendimeve, etj.

Edukim mjedisor i komunitetit nëpërmjet workshopeve dhe trajnimeve, programeve në media, publikim të materialeve të ndryshme, aktivitete të lidhura me shkollat dhe studentët, etj. Për realizimin e objektivave të tyre, ato kanë synuar kryesisht në sensibilizimin e opinionit publik. Protestat publike janë shfaqur kryesisht në formën e peticioneve të firmosura të drejtuara strukturave të qeverisjes qendrore dhe lokale.

3.8 Strategjia për zhvillim Hapësinor të Prishtinës

Strategjia e zhvillimit hapësinor është një nder kapitujt me të cilën ipen përgjigje në pyetjet se “si të arrihen” objektivat e specifikuar, më parë së bashku me programet, projektet dhe masat. Në këtë kaptinë do të detajohen mënyrat se si do të mbërrihet deri tek zbatimi I objektivave SMART, të cilat duhet të jenë : Specifike, të Matshme, të Arritshme, Reale dhe Të specifikuar në kohë. Kjo kaptinë do të përfundojë me:

1) Listën e përgjithshme të projekteve të dalë nga lista e synimeve, objektivave, programeve e projekteve të definuara në kohë dhe kosto;

II) Listën e projekteve prioritare të specifikuara në kohë dhe kosto, me specifikim të përgjegjësve në zbatim dhe mbështetje të programit, projektit, masës apo të veprimit.

Temat e elaboruara do të jenë të strukturuar sipas rradhitjes së synimeve, të paraqitura dhe në tabelën e mësipërme, përderisa shqyrtimi i tyre do të bëhet përmes tri grupacioneve tematike për elaborim:


· *Aspekt fizik dhe hapësiror* – Se çfarë do të duhej të akomodohej dhe mundësohej në aspekt të locimit

apo dhe përcaktimit fizik të tyre në hapësirën e qytetit;

· *Aspekt institucional* – Se çfarë nevojitet të themelohet, mbështetet për të funksionuar zbatimi I

projektit për mbërritjen e objektivës, synimit për vizionin e përbashkët;

• *Aspekt financiar* – Se çfarë nevojitet në aspekt të sigurimit të financimit fillestar apo dhe të vazhdueshëm për të mundësuar zbatimin





Harta 2. Zhvillimi hapesor i qytetit të Prishtinës

4. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM

4.1. Metodologjia

Kryerja e VSM për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Prishtinës, është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikepamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi i Planit Zhvillimor Komunal të propozuar.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis dhe ligjin për VSM, i cili është transpozimi i direktives së BE. Mbeshtetur në sa mesipër VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- a) një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- b) përshkrim të Vizionit, priritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- c) përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritshëm të tij në rast se nuk zbatohet plani ;
- d) përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- e) përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- f) përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- g) përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- h) Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- i) një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- j) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

Plani Zhvillimor Komunal për numurin e madh dhe diversitetin e gjere të problematikes që trajton, kërkon konsultimin e një game të konsiderueshme dokumentacioni. Behet fjalë për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektore të ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përfshijë materialeve që dispononte vetë Grupi hartues i VSM-s,

u sigurua nga komuna e Prishtinës, institucione te tjera publike dhe kerkimet ne internet. Me poshte po rendisim disa nga dokumentat kryesore qe u perdoren ne trajtimin e aspekteve te ndryshme mjedisore për komunën e Prishtinës dhe me gjere.

4.2. Literatura dhe Burime te Shkruara Informimi per VSM

Materiali që përben Detyren e Projektimit, sqaruar në dokument si Plani Zhvillimor Urban i hartuar nga grupet punuese, trajton ne menyre serioze problemet mjedisore te komunës së Prishtinës.

Ky dokument nder te tjera permban informacion lidhur me shtrirjen gjeografike, gjeologjine, sizmiken, hidrologjine, hidrografine, mbetjet e natyrave te ndryshme, cilesine e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, ekonomine, infrastrukturen, transportin, urbanistiken, informacion mbi sektoret socio-ekonomik. Ne pergjithesi materiali eshte i kompletuar, në veçanti në trajtimin e problemeve mjedisore me te cilat perballlet komuna. Ai permban të dhena analitike mbi mjedisin fizik, mbetjet, cilesine e ajrit dhe te ujrave siperfaqesore, etj.

Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në mjedis kanë percaktuar vizionin per mjedisin i cili perkufizohet si: zhvillimi i qendrueshem i vendit duke mbrojtur pasurite natyrore nga ndotja dhe demtimi dhe promovimi i vlerave mjedisore. Per realizimin e këtyre prespektivave, investimet per mbrojtien e mjedisit me qellim qe standardet e Bashkimit European te mund te arrihen brenda vjeteve te ardhshem do te fokusohen ne fushat e meposhtme:

-Trajtimi i ujrave te ndotura;

- Menaxhimi i mbetjeve te ngurta dhe ndertimi i vend-depozitimeve sipas standardeve te BE;

- Mbyllja ne zonat e ndryshme e vend-depozitimeve ekzistuese;

- Rehabilitimi i tokave te ndotura dhe burimeve te ndotjes;

- Permireshime teknologjike ne objektet industriale

Drejtimit e mesiperme per rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit, jane probleme prioritare per komunën e Prishtinës. Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës paraqet nje plan të hapësirës së Prishtinës dhe propozon zhvillime të perdorimit tokës e të infrastrukturës deri në vitin 2023+. Ai nënvizon gjithashtu edhe nevojën për të adresuar boshllëqet financiare, njerëzore e të burimeve institucionale për një ekzekutim efektiv të planit.

Mbi bazen e programit te Qeverise për mbrojtjen e mjedisit, ajo percakton edhe qellimet të cilat në mënyre të përmbledhur jane:

- Përmbushja e standarteve të kërkuara (BE, Organizata Boterore e Shendetesise - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbetjet urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;

- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;

- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë për përdorim aktual dhe në të ardhmen;

- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;

- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona europiane dhe ndërkombëtare;
- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në considerate në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe;
- Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve. Pothuajse të gjitha këto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë problem me të cilat ndeshet edhe komuna e Prishtinës. Zbutja dhe zgjidhja e tyre përben një kontribut madhor në realizimin e këtij Plani. Për një vlerësim sa më real të situatës mjedisore në komunën e Prishtinës dhe luhatjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës të nxjerra nga Detyra e Projektimit (Plani Zhvillimor Komunal), informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, zhurmave, manaxhimit të mbetjeve, etj, u gjeten në Raportet e Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenta tjera të nivelit qendrorë, përgatitur nga institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

4.3. Takime dhe Biseda me Perfaqësues të Institucioneve

Autoret e raportit të VSM kanë pasur fatin të jenë përfshirë në shumë takime dhe mbledhje me përfaqësues të institucioneve të ndryshme në kuadër të hartimit të PZHU-së. Disa nga hartuesit kanë qenë edhe anëtarë të Grupeve punuese që u ngriten për të kryer punën e hartimit të PZHU-së. Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve profesionale të qeverisjes komunale dhe qendrore, si edhe botes akademike dhe eksperte të pavarur kanë zhvilluar një dyzine mbledhjesh për të përcaktuar ecurinë e PZHU-së që nga fillimi deri tek debatet mbi zgjidhjet hapësinore apo infrastrukture.

Shenimet e këtyre mbledhjeve janë bërë pjesë e shqyrtimit nga autoret në kuadër të përgatitjes së raportit të VSM. Në mënyrë të ngjashme, Grupet punuese me përfaqësues të institucioneve të qeverisjes komunale dhe qendrore, me përfaqësues edhe të shoqërisë civile dhe sektorit privat gjatë disa takimeve kanë debatuar për vizionin e zhvillimit të komunës në nivel më të gjërë. Edhe shenimet e këtyre takimeve janë shqyrtuar nga autoret e raportit të VSM.

Nga proces-verbalet e mbledhjeve dhe takimet me anëtarë të Grupeve punuese të komunës së Prishtinës, si edhe me Drejtorinë e Planifikimit Urban prane kësaj komune, janë marrë informacione dhe të dhëna të ndryshme që lidhen me shtrirjen e komunës (gjeografia), projeksione të popullsisë në zonat e ndryshme të komunës, zonimin, peizazhin, infrastrukturen rrugore, zonat rekreative, zonat e ndotura, menaxhimin e mbetjeve, infrastrukturen e ujit të pijshëm, ujërave të zeza dhe të bardha, zonat e parkimit. Këto informacione dhe takime kanë ndihmuar grupin e hartimit të VSM-s, të fokusohet më mirë në zonat ekzistuese të Komunës dhe sipërfaqe që mendohet të shtohen, ku parashikohen zhvillime të caktuara.

Gjithashtu takime janë realizuar me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me problematiken mjedisore në komunën e Prishtinës, zonat e ndotura mjedisore (hot spote) dhe zonat me rëndësi ekologjike. Këto takime kanë ndihmuar autoret të vecanërisht në hartimin e kritereve kufizuese mjedisore.

4.4 .Struktura e Raporti Përfundimtar të VSM-se

Raporti përfundimtar do të jetë i ndarë në kapituj, kështu që secili kapitull do të përmbaj në vete materialin i cili në mënyrë të qartë dhe specifike ka shtjellime dhe sqarime lidhur me VSM.

Kapitulli I^{rë}, i cili paraqet sfondin, të dhënat historike, nevojën për VSM, bazen e PZHUP-it, Objektivat e VSM –se.

Kapitulli II^{të} ,ka të bëjë me legjislacionin, konventat mjedisore, institucionet dhe vlerësimin e demit mjedisor.

Kapitulli III^{të}, përfshinë ne vete Direktivat e BE-se, Informimin e publikut ,pjesëmarrjen ne vendimmarrje, objektivat e mijeveqarit

Kapitulli IV^{të} katert ka të bëjë me zhvillimin e strategjive për mbrojtjen e mjedisit si strategjinë zhvillimor të Komunes se Prishtinës.

Kapitulli V^{të}, paraqet gjithashtu procesi dhe metodologjia per VSM si edhe burimet e shkruara apo takimet e kryera ku autoret jane bazuar ne kuader te pergatitjes se projekt-raportit perfundimtar te VSM-se.

Kapitulli i VI^{të} paraqet nevojën dhe objektivat e PZHUP-së, si edhe marrdheniet e tij me planet dhe programet qe kane lidhje me të. Paraqitet një përmbledhje të qëllimit dhe komponentëve të PZHUP- it dhe të mënyrës së integritimit të tij me planet e tjera të qytetit, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore, në këtë kapitull përfihien edhe analiza si dh historiku i zhvillimeve te paneve te mëparshme, zhvillimi, urban, popullata, faktoret , skenaret, alternativat e shpërndarjes hapesinore.

Ketu pasqyrohet situata mjedisore, perfshire infrastrukturen dhe aspekte socio-ekonomike, ne komunën e Prishtinë dhe rreth e saj.

Kapitulli i VII^{të} ,mbeshtetur ne publikimet mbi gjendjen e mjedisit në komunën e Prishtinës do te analizohen treguesit e cilesise se mjedisit; fizik dhe biologjik (gjeologjia, hidrologjia, sizmika, perdorimi i tokes, biodiversiteti, cilesia e ajrit, e ujrave siperfaqesore, ndotja e tokes, pikat e nxehta mjedisore, niveli i zhurmave, menaxhimi i mbetjeve ne pergjithesi dhe atyre urbane ne vecanti, siperfaqet e gjelbra, etj). Mbi bazen e kesaj analize do te vleresohet situata mjedisore aktuale dhe do te identifikohen zonat me problematike te qytetit si ne aspektin e ndotjes ashtu dhe vlerave rekreative.

Kapitulli i VIII^{të} – ka të bëjë me situaten mjedisore-mjedisi fizik, gjendja bidiverziteti, speciet e zbuluara deri me tani, toka,ajri, uji, mbeturinat energjia , analiza SWOT (qe ka te beje me mjedisin),

Kapitulli i IX^{të} ka të bëjë me mjedisin fizik. Ne kete kapitull evidentohen perpaesite e zhvillimit te planifikuar ne drejtim te krijimit të një komune me më teper infrastruktur dhe me pake zhurme e pluhur, me me shume hapesira te gjelbra dhe me te paster, e njekomune qe rritet dhe zhvillohet me nje cilesi jete me te mire qe orjentohet nga parimet e zhvillimit te qendrueshem.

Ne kapitullin e X^{të} pëfshin burimet ujore

Ne kapitullin e XI^{të} ka të bëjë me krahasimin e alternativave , Ne kapitullin e XII , ka te beje me kritetret qe kufizojne zhvillimin urban, Ne kapitullin e XII perfhine mastambi zbutjen , XIV Monitorim, XVI perfhin eperfundimet.

Mbi bazen e informacionit mbi situaten aktuale mjedisore, ndikimet eventuale te PZhU-së ne shendetin e njeriut dhe elementet e mjedisit dhe ne perputhje me kerkesat e legjislacionit per mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin komunal, në të propozohen masa per zbutjen e çdo ndikimi negativ ne cilesine e mjedisit nga zbatimi i PZHU-së.

Do të vleresohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alterantivat e zhvillimeve të PZHU-së, me objektiv që të permiresohet cilesia e jetes së qytetarëve të komunës që banojnë aktualisht dhe që do të akomodohen në të ardhmen. Mbi bazën e vleresimit analitik të cilesisë së elementeve të mjedisit si ajrit, ujërave sipërfaqesore, dhe netokesore, mbetjeve të ngurta, zhurmave, sipërfaqeve të gjelbra, në zonat e ndryshme të komunës, do të behen propozime për masa zbutese të përgjithshme dhe specifike, sipas karakteristikave dhe mundësive që lejohen për ndërhyrje për të konsideruar nga ekipi i hartimit të PZHK-së. Në përgjithësi masat zbutese dhe kufizuese/ndaluese do të synojnë që të permiresojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të behen në përputhje me standardet mjedisore.

Dhe në fund përfshihet literatura e shfrytëzuar për raportin VSM-së, dhe shtojcat 1 dhe 2

4.5. Nevoja për Plan Rregullues

Prishtina ka përjetuar një proces frenetik urbanizimi në vitet e fundit. Pas rënies së regjimit totalitar në vitin 2000, rajoni i Prishtinës ka përjetuar migrimin masiv të një pjese të popullatës nga zonat rurale dhe ato të thella malore drejt zonave periurbane të qytetit. Kuptohet që ky rajon ka përjetuar dhe një shtrirje në sipërfaqen e urbanizuar por gjithashtu dhe një intensifikim të pjesës së konsoliduar të qytetit për shkak të pamundësisë së shtrirjes së infrastrukturës në zonat periurbane. Plan i rregullues ekzistues, i vitit 1986 - 2000 dhe 2004 - 2012, as që parashikonte, as që planifikonte një zgjerim kaq masiv të qytetit. Në vitet e para të tranzicioni mungesa e PZHUP, është justifikuar me (i) mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe financiare (ii) paqartësinë profesionale për natyrën e politikës për të përballur me këtë fenomen, dhe (iii) pa aftësinë për të kthyer çështjen e urbanistikës në një prioritet qeverisës. Ndërsa në 10 vjeçarin e dytë të tranzicionit, dukshëm, çështja e zhvillimit urban ndërtoi interesa që u konsoliduan në sektorin e ndërtimit me ndikim të dukshëm në ekonomi, por që nuk ishin vazhdimisht në balancë me interesin publik. Kjo situatë justifikoi gjithmonë ndërhyrje të pjesshme në indin urban të qytetit pa u kujdesur për një vizion të përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm urban të të gjithë qytetit të Prishtinës dhe atë më pak të të gjithë rajonit të Prishtinës.

Kjo gjë ka rezultuar në një hapërdaje urbane me një përdorim të paefektshëm të tokës, që është i kushtueshëm për shërbimet dhe kërkon mobilitet të lartë. Në pjesën qendrore të Prishtinës, ngjeshja kaotike e qytetit ushtron presion në shërbimet ekzistuese, shkakton humbje të trashëgimisë dhe zvogëlon zonat e gjelbërta dhe të qarkullimit. Në tërësi, në qytet ka ndodhur një degradim serioz mjedisor.

Në këtë mënyrë, Komuna e Prishtinës vendosi të përgatisë dhe miratojë një plan të rregullues që do të përgjigjej më mirë situatës aktuale të përdorimit të tokës dhe do të akomodonte nevojat e qytetit për planifikim dhe zhvillim. Ndërsa viteve të fundit, dukshëm, çështja e planifikimit dhe zhvillimit komunal dhe urban ndërtoi interesa që u konsoliduan në sektorin e ndërtimit me ndikim të dukshëm në ekonomi, por që nuk ishin vazhdimisht në balancë me interesin publik. Kjo situatë justifikoi gjithmonë ndërhyrje të pjesshme në indin ndërtimor të vendëbanimeve pa u kujdesur për një vizion të përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm komunal në të gjithë vendbanimet Prishtinës. Kjo gjë ka rezultuar me një përdorim të paefektshëm të tokës, që është i kushtueshëm për shërbimet dhe kërkon mobilitet të lartë.

Në këtë mënyrë, Komuna e Prishtinës vendosi të përgatisë dhe miratojë një planin zhvillimor komunal që do ti përgjigjej më mirë situatës aktuale të përdorimit të tokës dhe do të akomodonte nevojat e komunës për planifikim dhe zhvillim për të gjithë.

4.6. Objektivat e Planit

Qyteti i Prishtinës duhet të ketë një planifikim zhvillimor urban modern dhe efikas, duke u bazuar në normat dhe standardet Evropiane dhe të cilat ngërthehen në një Plan Zhvillimor Urban.

Objektiv i hartimit të PZHU të Prishtinës 2013 – 2023 është diagnoistikimi dhe planifikimi apo projekcioni për të ardhmen e qytetit të Prishtinës me të dhënat e disponueshme.

Përmbajtja e PZHU të Prishtinës 2013 – 2023 bazohet në “Ligjin për Planifikim Hapësinor nr.2003/14 dhe Udhëzimin Administrativ mbi elementet themelore të Planit zhvillimor urban dhe është I ndarë në 5 faza të planifikimit:

- I. Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes;
- II. Vizioni, parimet dhe caqet;
- III. Korniza e zhvillimit hapësinor urban;
- IV. Struktura dhe lokacioni hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm,
- V. Dispozitat dhe masat për zbatim

Të dhënat e përdora në hartimin e Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës 2013 – 2025, qofshin ato tekstuale apo grafike, kanë burimin nga:

- i) Agjensionin e statistikave të Kosovës;
- ii) Departamentet përkatëse të Komunës së Prishtinës;
- iii) Departamentet e Ministrive;
- iv) Vlerësimet nga hulumtimet për fusha të ndryshme sektorale;
- v) Terreni, përmes vrojtimit, fotografimit;
- vi) Ortofotot e vitit 2010, imazhet satelitorë të vitit 2011 dhe të tjera.

4.7. Historiku i Planeve dhe Analizë e Situatës Ekzistuese

Prishtina është kryeqyteti i Kosovës, me rreth 180 000 banorë në pjesën urbane dhe sipërfaqe urbane prej 77.68 km². Është qyteti më i populluar në Kosovë, ku janë të përqëndruara institucionet kryesore qeveritare dhe diplomatike e konsulare, të arsimit të lartë, institucionet kulturore, shkencore e shëndetësore.

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës Prishtina është Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, statusi i të cilit ende nuk është i rregulluar me ligj të veçantë për kryeqytetin. Dokumentacioni arkivor për planifikimin e Prishtinës bazohet në shënime jo komplete, të mangëta, shënime nga udhëpërshkrimet e ndryshme dhe monografitë, me shumë pak dokumentacion hartografik.




Fig. 1 Zhvillimi historik i qytetit të Prishtinës

Në aspektin kronologjik, veprimet në lidhje me planifikimin dhe rregullimin e pjesës urbane të qytetit të Prishtinës ishin;

"Plani i Rregullimit të Prishtinës, i hartuar në vitin 1937 (shënimi nga monografia e Prishtinës) dhe nga "Programi urbanistik i qytetit të Prishtinës" - i punuar në vitin 1970. Përfshinte sipërfaqen prej 192,72 ha me numrin e planifikuar të popullësisë prej 16.000 banorëve.

"Plani i dytë i rregullimit", I hartuar në vitin 1948, porse nuk ka gjurmë për ekzistimin e ndonjë pjese të këtij dokumentacioni, as për parametrat themelorë të tij.

Plani i Përgjithshëm Urbanistik i Prishtinës - I hartuar më 1950, project ky I cili përfundoi në vitin 1953. Planifikohej për deri në vitin 1980, përderisa qyteti ishte planifikuar për 50.000 banorë. Territori i Prishtinës ishte organizuar për 950 ha.


Më 1965 u mor vendimi për zgjerimin e kufijve të rajonit ndërtimor të qytetit në 1950,00 ha (Shënimi nga "Programi urbanistik" i vitit 1970). Duke gjykuar sipas shënimit del se kjo hapësirë ishte planifikuar për 107.954 banorë deri në vitin 1980. Ky duhet të ketë qenë ndryshim dhe plotësim i PPU-së, për të cilin nuk ka gjurmë të dokumentacionit;

Më '1965, filloi hartimi i "Planit 'direktiv të trafikut dhe dedikimit të sipërfaqeve të qytetit", i cili përfundoi dhe u aprovua më 1967. Planifikohej për 100.000 banorë në 1950,00 ha sipërfaqe. Nga dokumentacioni ka mbetur vetëm shtojca grafike e dedikimit të sipërfaqeve në P=1: 2.500;


Më 1969 është marrë vendimi me të cilin "Planin direktiv të trafikut dhe të dedikimit të sipërfaqeve të qytetit" e zëvendëson Plani i Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës, përderisa kurse PPU i vitit 1953 hiqet nga fuqia.

Më 1970, Enti për Zhvillimin Ekonomik dhe Shoqëror të Prishtinës hartoi "Programin Urbanistik të Qytetit të Prishtinës dhe të Vendbanimeve Periferike". Pasi përpjekjet për të gjetur ndonjë organizatë urbanistike, e cila do ta merrte përsipër hartimin e PPU-së, nuk dhanë fryt. Programi urbanistik i punuar, si përpjekje e bërë mbeti qëllim për vetvete, kurse pasqyra përcjellëse grafike e tij (sipas Ligjit –pjesë përbërëse e Programit) vetëm sillte huti në punën e shërbimit urbanistik të Komunës.

Me 1975, pas përgatitjeve dyvjeçare për fillimin e hartimit të PPU-së, u aprovua "Projekti i Detyrës për Hartimin Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës" dhe u mor vendimi për fillimin e hartimit të PPU-së (Fletorja zyrtare e KSAK" , nr"51/75) .7



Harta 3. Plani i përgjithshëm i Prishtinës 1986-2000



Harta 4. Plani strategjik i Prishtinës 2004-2012

Koncepti i dokumentit të aprovuar me modelin e procesit të hartimit të PPU-së, kishte për qëllim të vendosë bazat për fillimin e planifikimit dhe rregullimit të vazhdueshëm, të hapësirës së Prishtinës. Planifikimi i Prishtinës ishte përfshirë dhe me planet hapësinore të rendit më të lartë, Planin Hapësinor të KSAK-ut të vitit 1978 dhe Planin Hapësinor Rajonal të Kosovës për të cilin nuk ishte aprovuar nga Kuvendi I Komunës së Prishtinës.

Më 1988 është aprovuar Plani i Përgjithshëm i Prishtinës për periudhën deri në vitin 2000, për numër të banorëve 225.000 dhe me sipërfaqe prej 4335 ha.

Më 2004 është aprovuar Plani Strategjik i Prishtinës për periudhën deri në vitin 2020, për numër të banorëve 650.000 dhe me sipërfaqe prej 4335 ha.

4. 8. Problematika të Zhvillimit dhe Planifikimit Urban në Prishtinë

Prishtina në ditët e sotme përballlet me një seri problemesh që rrjedhin nga një mungesë planifikimi konsistent ndër vite. Rajoni i Prishtinës vuan një zhvillim të pabalancuar rajonal. Me të vërteta nuk është arritur që të koordinohen politika për zhvillimin urban në rajon. Për këtë shkak politikat urbanizuese kanë qenë jo efikase. Nëse Prishtina ka përjetuar një intensifikim të pjesës ekzistuese të qytetit, rajoni ka përjetuar dhe fenomenin të ashtuquajtur si shtrirje e paplanifikuar, sidomos në pjesën, lindore, perendimore veriore dhe jugore të saj. Zhvillimi i pjesëve të ndryshme të këtij rajoni ka qenë spontan dhe i paudhëhequr nga investimet publike. Qyteti i Prishtinës gjithashtu vuan një mungesë balance edhe midis zhvillimeve private dhe interesave publike. Gjatë procesit të intensifikimit të qytetit si pasojë e një urbanizimi pa plan, përveç fenomenit të zënies së tokës bujqësore në mënyrë joeficiente (me dendësi të ulëta ndërtimore), ka prevaluar dhe fenomeni i zënies së hapsirave publike me ndërtime me leje dhe pa leje. Në fakt edhe zhvillimet e reja urbane bazuar në ashtuquajturit plane pjesore kanë zënë vënd në kurriz të hapsirave publike dhe shoqërore.

Në vitet e fundit Prishtina ka humbur strukturën urbane të fituar ndër vite. Për shkak se planet kanë theksuar vetëm dimensionin ndërtimor, është humbur njësia strukturore urbane e qytetit. Kjo ka ndikuar për keq edhe në përlogaritjet dhe sigurimin e hapsirave të nevojshme për funksione publike. Githashtu kjo ka ndikuar për keq edhe në organizimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Ky model zhvillimi urban ka qenë bazuar në principin e zhvillimit të pronës private. Por për shkak se në vitet e fundit është përjetuar fragmentarizimi i pronës si dhe për shkak se Kosova nuk ka një traditë të hershme të ekzistencës së rregullave të ekonomisë së lirë dhe pronës private, edhe zhvillimi urban është karakterizuar nga fragmentarizimi. Është evidente që projektet e zhvillimit urban nuk kanë qenë të përmasave të një blloku a kompleksi banimi. Përkundrazi zhvillimet kanë qenë aq të fragmentarizuara sa që sicili zhvillues/pronar toke të synojë maksimalizimin e përfitimeve afatshkurtër të parcelës, duke komprometuar zhvillimin afatgjatë të të gjithë zonës.

Për shkak të këtij modeli të fragmentarizuar zhvillimi ka mbijetuar dhe fenomeni i pabarazisë së shpërndarjes së përfitimeve të zhvillimit. Në fakt modeli i planifikimit nuk ka ofruar asnjë formulë se si vlera e përfituar nga zhvillimi urban të shpërndahet proporcionalisht dhe në mnyrë të drejtë midis pronarëve të tokës. Kjo pabarazi ka çuar në një presion të çbalancuar mbi tokën, duke bërë që çdo parcele të jetë nën presionin e zhvillimit privat, pa arritur të sigurojë hapsirat e duhura për aktivitete publike, ose pa arritur formula kompensimi për hapsirat ku zhvillohen aktivitete publike.

Modeli i zhvillimit dhe planifikimit urban nuk ka arritur të sigurojë më shumë se sa një zhvillim të ndërprerë dhe të pakonsoliduar. Është e zakonshme pamja ku shihen se si ngrihen ndërtime të reja shumëkatëshe megjithëse zona nuk është përgatitur për urbanizim. Shpesh herë për shkak të këtij modeli bashkëjetojnë për vite me radhë zhvillime të vjetra me densitet të ulët ngjitur me zhvillime të reja shumëkatëshe që kërkojnë tjetër intensitet infrastrukturë. Kjo ndikon për keq në pamundësinë e autoriteteve publike për të planifikuar investime publike të duhura si dhe pamundësinë për të taksuar siç duhet zhvillimet.

Vetë sektori i ndërtimit, për shkak të këtij modeli përballet me vështirësitë e veta. Sektori i ndërtimit nuk është i strukturuar. Nuk është e qartë ndarja midis zhvilluesit, investitorit, financuesit, ndërtuesit, kontraktorit. Këto role i gjen të mishëruara brenda secilit projekt dhe kjo e ve në vështirësi sektorin dhe nuk e le që të specializohet në secilin drejtim.

Në këtë kuadër mungon raporti dhe partneriteti midis sektorit privat dhe atij publik në realizimin e projekteve të konsoliduara, të qëndrueshme dhe cilësore që do bëjnë të mundur realizimin e projekteve në kompleksitetin e tyre si dhe do rriste siguronë e realizimit të projekteve.

5. Rrjeti Rrugor

Krijimin e rrjetës së rrugëve me hierarki të qartë dhe përfundimisht të mbahet trafiku transit jashtë qytetit si dhe kufizimi i përdorimit të papërshtatshëm të rrugëve urbane.

Dispozita e unazës së Brendshme dhe asaj të Jashtme, shërbejnë për të parandaluar hyrjet në qytet që të mos behen kryqezime të fluksit të trafikut dhe të ofrojë një permiresim të shpërndarjes në rrugë kualitative urbane, me krijimin e trotuareve dhe rrugicave për çiklistë.

Unaza e Brendshme duhet të jetë një boulevard i madhë i qytetit, me karakter jo periferik. Do të lejon kyqje dhe parkim përgjatë rrugës paralele shërbyese. Mund të caktoj hapësirë për të gjithë shfrytëzuesit të rrugëve (korsit e automobilave, korsi të dedikuara autobusave ose tramvajeve, rrugicave për çiklistë, shërbimeve rrugore, parking në vijë dhe në fund trotuare të gjera). Kalim prej korsive të rrugëve kryesore të rrugët me shërbim duhet të bëhet e mundur vetëm me kryqëzim, në mënyrë që të mos ndërpresin fluksin.

Unaza e Jashtme duhet të jetë një by-pass për qytetin e Prishtinës, lidhjen e të gjitha rrugëve të Kosovës me secilën prej tyre si dhe zonat periferike të qytetit¹. Pjesa në anën veriore të Liqenit të Badovcit ka një mundësi alternative më të lirë në lidhjen me rrugët egzistuese të pjesës Jugore të

liqenit. Deri sa kjo kërkon kooperimin me Gracanicën të dyja alternativat duhet të mirren në konsideratë.

Duke ju referuar të ashtu quajturës “Unaza e Jashtme” është më të vërtetë një by-pass që të parandalojë fluksin e papërshtatshëm për të hyrë në qytet. Trasa duhet të rikonsiderohet në përfundim, afër trasës së hekurudhës më tej kah jugu, për të krijuar më shumë distancë në mes të rrugëve si dhe vendbanimeve egzistuese dhe të planifikuara dhe të unazës së brendshme; kjo zgjidhje jep në dispozicion më shumë hapësirë për zhvillim urban.(shiko imazhin më poshtë).



Harta 5. Rrjeti rrugor i Prishtinës

5.1. Trafiku dhe Transporti

Lëvizja e njerëzve dhe e mallrave në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme si vizion lidhur me trafikun dhe transportin.

Synimi I. Krijimi i një sistemi të trafikut complete dhe efikas, për qytet dhe Zone Urbane më të madhe, mbajtja e trafikut transit jashtë qytetit; implementimi i tri “unazave” për organizimin e rrjetit të transportit.

1. Synimi II. Krijimin e efikas të një sistemi të autoparkingut në qytet dhe një shkëmbim periferik i autoparkingjeve për të reduktuar hyrjen e automjeteve në bërthamën e qytetit (Brenda unazës së qytetit, qendrës historike).

2. Synimi III. Mirëmbajtje e rregullt e rrugëve të vjetra dhe rregullimin e rrugëve të reja për transport më efikas(posaqërisht në zonat rurale);

3. Synimi IV. Zhvillimin e sigurtë dhe të rregullt të linjave të transportit publik dhe modernizimin e automjeteve të transportit publik


4. Synimi V. Mbajtjen dhe ruajtjen e lidhjeve hekurudhore(ose tramvajeve) me polaritete të ndryshme urbane(aeroport, stacione të autobusave, qendra e qytetit etj.)

5. Synimi VI. Zhvillimin e rrjetit të rrugëve për çiklist dhe përmirësimin e rrugëve për këmbësor dhe pengesat e rrugëve të lira.

6. Synimi VII. Organizimi i transportit të mallrave brenda qytetit(kyçe me kohë të kufizuar; zvogëlim si dhe emetim i ulët i automjeteve etj.)

Duke u bazuar në këto qëllime, PZHK-s propozon këto veprime kryesore për të përmirësuar mobilitetin urban të njerëzve.

Transformimin e hekurudhës ekzistuese Fushë Kosovë – Prishtinë - Podujevë në linjë të transportit urban në masë më të madhe(linjë metropolitane), me ndalesa që ofrojnë transfer vende parkingje intermodale dhe depo në varg;
Krijimin e akseve të forta të transportit publik të dedikuar autobusave.




Harta 6: linja kryesore e transportit publik- propozimi


5.2. Lidhja në mes kryeqytetit dhe rrjetit nacional dhe internacional (transporti i pasagjerëve)

Propozimet e pasuara janë të bazuara në mundësinë për të përforcuar anën perëndimore të Prishtinës si një korridor infrastrukturor, për të riorganizuar flukset ekstra-urbane të njerëzve dhe të transportit të mallrave brenda/jashtë qytetit. Në ndërtim e sipër në anën perëndimore të qytetit është autostrada Nish-Tirane-Durres. Më largë në anën perëndimore shtrihet linja 2 hekurudhore, ku stacioni i pasagjerëve (nuk i përmbushë standardet internacionale) është i vendosur 8 km nga Prishtina; në anën jugore të stacionit të pasagjerëve shtrihet stacioni hekurudhorë i transportit të mallrave (jo adekuat), është koneksion hekurudhorë, I startuar si linjë shërbimi për industry dhe minjera, janë ende egzistuese, por shpesh jashtë përdorimit (një nga këto lidhje kalonë afër zonës së aeroportit, i vendosur në anën jug-perëndim). Në lidhje me rrugët që hyjnë në qytet, struktura hierarkike nuk egziston. Po ashtu as përceptimi I pranueshëm kualitativ I hyrjes në qytet. Të dyja tregojnë një situatë totale të pa mjaftueshme që një kryeqytet Evropian duhet të garantoj.

2 Linja internacionale e hekurudhës nga Beogradi në Shkup, kalon nëpër Fushë Kosovë, 8 km. Përfundimi i Prishtinës. Gjithashtu, në përfundim gjendet edhe linja e hekurudhës, e cila kalon nëpër Fushë Kosovë dhe vazhdon në Pejë dhe kah ana lindore në Podujevë dhe Nis.



Harta 7: Linjat egzistuese të hekurudhave ne Kosovë.



Harta 9. Hekurudhat egzistuese në zonën e Prishtinës: linja very-jug, lidhë Serbinë dhe Malin e Zipërmes Kosovës, me stacionin per pasagjer (very) dhe stacionine tranportit të mallrave (Jug) ne Fushë KOsovë, të dyja jo adekuate; Linja Fushë Kosovë –Pejë përdorë të dyjat për njerëzit dhe transport të mallrave, linja Fushë KOsovë-Prishtinë-Podujevë, pothuajse I shkarkuar por me rezerva të mëdha për tu ripërdorë, linja Bardh-Magure, shërben minjerën e nikelit në Magure dhe e kalon në afërsi të aeroportit.

5.3. Projektioni i Popullatës

Përmes projektionit të popullatës synohet të kuptohet struktura e popullatës në 15 apo 20 vitet e ardhshme. Mbi bazën e këtij projektioni synohet të kuptohen dhe të llogariten dhe nevojat për infrastrukturë dhe shërbime. Gjithashtu një panoramë e përgjithshme e strukturës së popullatës mund të krijojë shanse më të mira për planifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për investimet strategjike në këtë rajon urban.

Projektioni linear. Modeli linear prezupozon që rritja e popullatës zhvillohet në masë konstante. Grafikisht ky lloj projektioni paraqitet si një lakore lineare.

Projektioni eksponencial. Ky model presupozon që popullata rritet në „raport (apo përqindje) konstante. Kjo do të thotë që nëse rritja e popullatës ka një përqindje konstante prej vitesh, duhet projektuar duke i besuar kësaj përqindjeje rritjeje.

Projektioni i modifikuar eksponencial. Ky projektion parashikon që faktorët e rritjes së popullatës ndryshojnë me kohën por brenda një trendi relativisht të qartë. Grafikisht do të përshkruhej nga lakore që zbutet në kohë duke iu afruar limitit në kohë. Njësia urbanistike. Zona në studim është ndarë në zona projektimi dhe analize. Zonat e përfutuara janë integrimi I zonave të votimit për shkak të përafrimit të numrit të popullatës. Këto zona janë korrigjuar edhe me strukturën kufizuese që përfitohet nga një skemë e rrjetit rrugor.

Brenda secilës njësi është llogaritur popullata e zonës, sipërfaqja e ndërtuar dhe intensiteti bruto i popullatës. Në mënyrë që të korrigtohet intensiteti bruto i popullatës për këto zona, në llogaritjen e sipërfaqes janë zbritur sipërfaqet e shërbimeve që shërbejnë të gjithë qytetin dhe jo vetëm zonën.

Në këtë mënyrë është analizuar shpërndarja e intensitetit të popullatës. Më pas është projektuar shpërndarja e korrigjuar e intensitetit bruto të popullatës duke synuar që qytetit t'i ofrohet një llogjikë e drejtë e kësaj shpërndarjeje.

Kosova për nga dendësia e popullsisë renditet ndër vendet me dendësi të madhe në Evropë, me rreth 220 banorë/km². Komuna e Prishtinës – mbi 900 banorë/km², ndërkohë që rajonet më të pabanuara janë viset malore dhe kodrinore me dendësi përafërsisht 50 banorë/km². Për përcaktimin e profilit demografik të zonës urbane të Prishtinës në planifikimet e mëparme ishte sfidë kryesore mungesa e shënimeve relevante dhe të besueshme, mungesa e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në periudhën pas vitit 1981. Të gjitha përfundimet e deritanishme demografike ishin të bazuara në vlerësime, përderisa “Regjistrimi i vitit 2011” ofron informacione demografike në nivel të komunave dhe qendrave urbane, të cilat ndryshojnë nga trendet e deri tanishme bazuar dhe në rezultatet e implementimit të metodologjisë evropiane, të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Kjo panoramë e re do të përcaktojë më pas edhe aftësinë mbajtëse të secilës zonë për sa i takon funksioneve të parashikuara, sipërfaqes ndërtimore dhe infrastrukturës së projektuar në këto zona.

Në mënyrë që të përftohet dhe një ide e strukturës moshore të popullatës në 15-20 viteve të ardhshme, është ndjekur principi i metodës së mbijetesës. Në këtë mënyrë, duke marrë të dhënat bazë për strukturën ekzistuese moshore të popullatës dhe duke ndjekur raportet e lindje-vdekjeve dhe mbijetesave, projektojmë shpërndarjen moshore të popullatës me prezumimin që edhe rritja mekanike e popullatës reflekton strukturën moshore të rritjes natyrale.

Tabela 1. Indikatorët themelor demografik (pa përfshirë zonën e zgjeruar urbane)

z	Popullsia Kosova	Ekonomi familjare Kosova	Popullsia Komuna e Prishtinës	Ekonomi familjare Komuna e Prishtinës	Popullsia ne Prishtine (qyteti)	Ekonomi familjare Prishtinë (qyteti)
1948	733.132	115.292	44.324	8.000	19.631	4.667
1953	816.012	127.012	51.690	9.452	24.081	5.634
1961	964.084	152.606	70.116	13.706	38.593	9.059
1971	1.243.771	188.116	109.273	19.928	69.514	14.813
1981	1.584.440	228.884	148.656	26.721	108.083	21.017
1991 ⁸	1.956.196	289.246	199.654	35.974	155.499	29.642
2011 ⁹	1.733.872	295.070	198.214	40.292	144.677	31.105

Tabela 2. Burimi i te dhenave

Nr.	Burimi i të dhënave	Numri i banorëve			Baza
		Zona urbane	Komuna	Kosova	
1	ESI,1999	280.000		1.700.000	Indikatorë të ndryshëm specifik
	IMG,pas luftës së vitit 1999	283.00	338.000		Të dhënat e marra nga administrate locale,të pakontrolluara nga IMG
2	Komuna e Prishtinës	320.000 385.000			e panjohur
3	UNMIK/ESTAP/ Studimet e Bankës Botërore		502.000	2.073.000	(vlerësimi pë 2000)
4	ESK 2003			2.338.000	Shtimi në Kosovë 35.000-40.000 persona/vit
5	ESK 1981	111.480	150.000		Të dhënat nga regjistrimi, të vlerësuara si të qëndrueshme
6	ESK 1991		200.000	1.956.000	Të dhënat nga regjistrimi I fundit I vitit 1991.Të vlerësuara si të dyshimta
7	OSCE, 2000		545.000	2.364.000	Extrapolimi I nivelit të rritjes së popullsisë së dikurshme në Kosovë prej 2%/vit
8	Sypozimet e Planit Strategjik	350.000	420.000		Diskutimi me ekspertë

Duke vlerësuar trendet demografike në nivel të Kosovës, komunës dhe qytetit vërejmë një rritje të konsideruar të popullatës në periudhën 1948 – 1991. Në këtë periudhë, popullata e Kosovës ishte rritur për 2.6 herë, e komunës së Prishtinës për 4.5 herë dhe e qytetit të Prishtinës për 8 herë. Kjo ka rezultuar në pjesëmarrjen e popullatës së komunës së Prishtinës në atë të Kosovës nga 6.0 % (1948) në 10.2 % (1991). Edhe popullata urbane e Prishtinës ka treguar rritje të pjesëmarrjes nga 2.7 % (1948) në 8.0 % (1991) në popullatën e Kosovës. Popullata e qytetit e ka rritur edhe pjesëmarrjen në popullatën e komunës nga 44.0 (1948) në 78.0 (1991). Pjesëmarrja e popullatës së komunës dhe urbane në popullatën e Kosovë në regjistrimin e fundit tregon përafërsisht pjesëmarrje të ngjashme, nga 8.3 % në popullatën e Kosovës dhe 73% në popullatën e komunës.

Numri i përgjithshëm i banorëve në komunën e Prishtinës është 198.897 banorë, prej të cilëve meshkuj janë 49,8% ndërsa femra 50,2%, përderisa qyteti I Prishtinës I ka 149 000 banorë.

Një spektër i gjerë i të dhënave lidhur me popullsinë në Prishtinë dhe Kosovën, i marrë nga institucionet relevante, janë të bazuara në vlerësime. Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë (dhe në Prishtinë) është bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2011. Këto të dhëna nuk janë në harmoni me të dhëna nga paslufta në Kosovë. Lidhur me strukturën nacionale ende nuk ka të dhëna zyrtare nga censusi i vitit 2011, përderisa është e paraqitur në tabelën e mëposhtme .

Të dhënat për strukturën e moshës së popullsisë së Kosovës të përpiluara nga RIINVEST-i, edhe pse pa nënndarje sipas gjinisë, tregojnë një shtim të zakonshëm natyror, të pohuar deri para 10 vjetëve, i cila është tkurrur. Për shkaqe të kushteve të veçanta të periudhës, nuk mund të përshkruhen përfundime të vlefshme për shtimin e mëtejshëm natyror përtej këtyre të dhënave. Sidoqoftë, zhvillimi është në linjë me trendet e përgjithshme të shoqërive të industrializuara dhe jobujqësore të Evropës Perëndimore. Dy dekadat e fundit, nga viti 1975 e deri më sot, lindshmëria mesatare është ulur nga 35 për një mijë në 21 në vitin 1995 (MMPH - 2003). Mund të supozohet se zhvillimet e përgjithshme evropiane të lindshmërisë më të ulët, gjithashtu do të ndodhin edhe në Kosovë. Sipas vlerësimeve të institucioneve të Kosovës, pjesëmarrje dominante në popullsi ka grup – mosha 15-64 vjet (60.0 %) dhe 0-14

vjet (33.0 %) . Sipas këtij indikatorit demografik, Kosova ka popullsinë më të re në Evropë. Sipas statistikave të Eurostatit, moshë 0-14 vjet përbën vetëm 15,6% të popullatës.

5.4. Faktorët

Vazhdimi i procesit të urbanizimit: Është e qartë që procesi i urbanizimit do të vazhdojë të jetë një faktor kyç në dinamikën e rajonit të Prishtinës. Ky rajon vazhdon të jetë magneti tërheqës për zhvillimin ekonomik të vendit. Presupozohet që përqendrimi i popullatës rreth këtij rajoni do të vazhdojë edhe në vitet në vijim, pavarësisht se besohet që ritem e demografisë mekanike do të vijë duke u ulur duke qenë se procesi i urbanizimit është drejt një stabilizimi të tij.

Rritja natyrore: Kosova shquhet si vend me ritëm të lartë të rritjes natyrore si dhe për prezencën e një popullate të re në moshë. Megjithatë besohet që edhe Kosova do t'i përafrohet trendit të përgjithshëm europian (pavarësisht se në nivele më të buta) të uljes së ritmeve të rritjes natyrore të popullësisë. Natyrshëm kjo mund të çojë edhe drejt uljes së profilit të një popullate me moshë mesatare të re. Një fenomen i tillë është i natyrshëm dhe pasojë e ndryshimeve të formatit ekonomik të vendit.

5.5 Skenarët e projeksioneve

Skenari optimist

Në skenarin optimist presupozohet që ritmet e urbanizimit do të jenë në nivelin e 5%. Sipas këtij skenari në 20 vitet e ardhshme qyteti i Prishtinës kalon ndjeshëm prapun e 400.000 banorëve dhe i gjithë rajoni mund të kapë nivelin e 600.000 banorëve.

Skenari pesimist

Në skenarin pesimist, procesi i urbanizimit bie ndjeshëm, në nivelin 2%. Në një rast të tillë qyteti i Prishtinës nuk do kalonte 200.000 banorët në 20 vitet e ardhshme dhe rajoni nuk do kalonte prapun e 300.000 banorëve.


Skenari i moderuar

Skenari i moderuar që ka shanse më të mëdha për të qenë afër reales merr parasysh faktorët e sipërpërmendur dhe pranon që ritmet e urbanizimit do të vazhdojnë të jenë, por në masë më të moderuar me një tendencë të lehtë në rënie. Sipas këtij skenari Prishtina do të projektohet në nivelin e 500.000- 600.000 banorëve në 15-20 vitet e ardhshme ndërkohë që rajoni mund të rritet deri në nivelin e 700.000 banorëve.

5.6. Projektionet sipas Njësisë Urbanistike

Me realizimin e disa projekteve të komunikacionit rrugor dhe kycjes në korridoret ndërkombëtare, Prishtina është në process të forcimit të profilit urban si në kuptimin e strukturës demografike, administrative, zhvillimit njerëzor dhe atij biznesor. Konsiderohet se struktura e re urbane e Prishtinës do ta bëjë qytetin më atraktiv për biznese të jashtme dhe biznese ndërkombëtare në përgjithësi. Edhe qyteti kishte trashëguar një strukturë ekonomike mbi bazë të pronës shoqërore dhe publike. Efektet e privatizimit të pronës shoqërore edhe në qytetin e Prishtinës ishin të pamjaftuara për të krijuar vende të reja pune, rritur outputin dhe cilësinë e jetës. Edhe tani në qytetin e Prishtinës është selia e një numri të Ndërmarrjeve Publike qendrore dhe rajonale 10. Kjo dëshmon për fuqinë e bizneseve publike dhe ndikimin e tyre në jetën ekonomike të qytetit. Në qendren urbane të Prishtinës janë të regjistruara 24.458 biznese nga të cilat 10.249 në sektor të tregtisë dhe të shërbimeve, 2.653 në pasurit e pa tundëshme, qiradhënie dhe aktivitete biznesore, 2.815 në

transport, depo dhe telekomunikacion, 2.496 në hotele dhe restorante, 1.743 industri përpunuese, 1.471 në ndërtimtari dhe numër më të vogël në sektorë tjerë të ekonomisë.



Harta 10. Njesitë urbanistike të Prishtinës

Tabela 3. Bizneset e regjistruara dhe shpërndarja sektoriale

Sektorët	Komuna e Prishtinës	Qendra urbane
Gjithsejt	100.0	100.0
Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	1.2	0.9
Peshkimi	-	-
Industria e mineraleve dhe ekstraktuese	0.3	0.2
Industria përpunuese	7.3	7.1
Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë	0.2	0.2
Ndërtimtaria	6.0	6.0
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorike, motoçikletave, mallrat personale dhe të amvisnisë	42.0	41.9
Hotelet dhe restorantet	9.8	1.2
Transporti, depot dhe telekomunikacioni	12.5	11.5
Aktivitete financiare	0.7	0.7
Pasuritë e patundëshme, dhënia me çera dhe aktivitete e biznesit	10.2	10.8
Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale	0.4	0.4
Arsimi	1.0	1.1
Shendetësia	1.8	1.7
Aktivitetet tjera shoqërore (sociale)	5.7	5.4
Organizatrat eks –teritoriale	0.9	10.9

Aktivitetet biznesore të sektorit të shërbimeve kryesisht janë të koncentruara në hapësirën urbane të Qendres si dhe në zonat jera urbane siç janë Dardania, Ulpiana, Bregu i Diellit, Lakrishte, qendër dhe Aktash.¹¹ Vështruar nga aspekti i shpërndarjes së bizneseve të regjistruara dominon sektori i tregtisë, Riparimi i automjeteve motorike, motoçikletave, mallrat personale dhe të amvisnisë (41.9 %), Transporti, depot dhe telekomunikimet (11.5 %), pasuritë e patundëshme, dhënia me çira dhe aktivitete binesore (10.8 %) dhe ndërtimtaria (6.0 %). Duke pasur parasysh se qendra urbane është edhe kryeqytet dhe qendër administrative e Kosovës është e kuptueshme pjesëmarrja e ulët e industrisë përpunuese (7.1 %). Në periudhën e fundit në rrugët magjistarle të cilast po marrin karakter të autostradave është duke u fuqizuar ndërtimi i qendrave të mëdha tregtare. Në kuadër të qendres urbane në vitet e fundit janë formuar disa qendra tregtare duke përfshirë Pallatin e Rinisë, Grand Store, Bregu i Diellit, ING, Albi Mall, Dradania, ETC dhe tjerë. Këto qendra tregtare ofrojnë asortiman të gjerë të mallrave dhe punësojnë një numër të konsideruar të punëtorëve.

Edhe komuna e Prishtinës sikurse edhe Kosova pas përfundimit të luftës ishte përfituese e shumë programeve dhe projekteve të mbështetura nga komuniteti i donatorëve. Në kuadër të kësaj ndihme ishte përfshirë projektet e infrastrukturës bazike, rindërtimi i shtëpive, sektori i arsimit, shëndetësisë dhe l asistencës sociale. Krah as këtyre përpjekjeve të donatorëve, ishte zhvilluar edhe sistemi fiskal dhe buxhetor i sevisuar nga instrumente e grumbullimit të hyrave komunale dhe qendrore. Konsolidimi i të hyrave dhe shpenzimeve publike në komunën e Prishtinës mbështetej nga të hyrat vetanake dhe grantet Qeveritare.

Tabela 4. Struktura dhe dinamika e krijimit të buxhetit të komunës së Prishtinës

Vitet	Buxheti	Të hyrat vetanake	Grantët qeveritare	% e mjeteve vetanake	% e granteve qeveritare
2008	39.176.359	17.383.517	21.792.842	44.4	55.6
2009	43.302.523	14.000.000	29.302.523	32.3	67.7
2010	50.940.816	19.555.125	31.385.691	38.4	61.6
2011 (Plani)	59.487.719	20.175.922	39.311.797	33.9	66.1
2012 (Vlerësimi)	61.741.684	21.752.189	39.989.495	35.2	64.8
2013 (Vlerësimi)	63.371.731	21.757.920	41.613.811	34.3	65.7

5.7. Konsiderata mbi Alternativat e Shpërndarjes Hapësinore

Mund të konsiderohen tre skenarë potencialë hapësinor – i qendërzuar, i shpërndarë dhe poli-centrik (me shumë qendra).

Skenari i qendërzuar, bazohet në propozimin e planit rregullues ekzistues, por nuk është realist në atë që realizimi i tij do të kërkonte heqjen e shumicës së zhvillimeve përqark qytetit. Duke pasur parasysh përdorimin aktual të tokës dhe dendësinë në Prishtinë, ky skenar, siç thotë raporti, është i parealizueshëm.

Skenari i shpërndarë, reflekton tendencat ekzistuese ku zhvillimet tentojnë të jenë përgjatë rrugëve, me një densitet të ulët banesash rreth periferisë së Prishtinës. Është fjala për skenarin e “të mos bërit asgjë”.

Skenari i tretë propozon ruajtjen e Prishtinës si qendrën kryesore urbane, por duke zhvilluar gjithashtu edhe nyje të tjera urbane për të siguruar shërbime më të afërta e minimizuar udhëtimin në këto zona e madje edhe në vendet e punësimit. Në këto raporte bëhet krahasimi i këtyre skenarëve dhe vlerësimi i tyre, në bazë kriteresh të ndryshme, tregohet në figurën më poshtë.

Tabela 5 .Skenaret



Skenari	I qendërzuar	I shpërndarë	Poli-centrik
Skema			
Realizueshmëria ekonomike dhe institucionale	— —	+++	++
Ndikimet mjedisore	—	— — —	+++
Ndikimet sociale	+	— — —	++
Realizueshmëria politike	++	++	+
Konkluzioni	I paarritshëm	I papranueshëm	I realizueshëm

Figura: Krahasim tre Skenarëve të Zhvillimit

Ky vlerësim tregon qartë se skenari poli-centrik është i diferencuar nga të tjerët për përparësitë e tij. Megjithatë, PZHUP-ja nuk jep hollësi për mënyrën si janë vlerësuar këto kritere. Alternativa e qendërzuar dhe ajo poli-centrik janë pak a shumë të ngjashme për nga këndvështrimi mjedisor. Përparësia tjetër kryesore e alternativës së qendërzuar dhe asaj poli-centrike është se sigurimi i infrastrukturës është shumë më efektive nga pikëpamja e kostos, gjë që, sërish, është në ndihmë të mjedisit.

Tabela 6. Krahësimi Mjedisor i Skenarëve Kriteret

Tabela: Krahësimi Mjedisor i Skenarëve Kriteret	I qendërzuar	I shpërndarë	Poli-centrik
Çështje të mjedisit			
Hapësira të gjelbërta ekzistuese	+	- -	-
Hapësira të gjelbërta urbane	- -	+	O
Trupa ujore	O	+	+
Cilësia e Ajrit	- -	- - -	-
Mikro-klima	- -	+	O
Biodiversiteti / Ekologjia	+	- -	O
Përdorimi i burimeve (ujore)	O	O	O
Shkelja e kodrave	++	- - -	-
Transporti dhe automjetet	++	- - -	+
Ruajtja e trashëgimisë	- -	+	-
Lehtësia e monitorimit	+	- -	+
Totali mjedisor	-1	-11	-1

Tabela 6. + mirë; - keq; O pa ndryshim(Sqarim për shenjat e përdorura)

Qytetin e Prishtinës e karakterizon një trafik shumë i dendur, me numër të madh makinash, vende të pakta për parkim dhe cilësi jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndodjen ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës. Aplikimi i burimeve alternative të energjisë po shënon rritje të ngadaltë. Instalimi i paneleve solare në disa ndërtesa të qytetit QKUK-së e gjetiu është shembull nismëtar ku duhet përqendruar iniciativa tjera për të zbutur sadopak funrizimin e vëshirësuar me energji elektrike dhe rritjene efikasitetit energjetik.


Nxemje jo e mjaftueshme nga Ngrohtorja e qytetit dhe përdorimi i rrymës elektrike dhe drunjëve për ngrohje e rëndojnë gjithnjë e më shumë situatën mjedisore dhe jetën e qytit e bëjnë më të vështirë.

Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është i kufizuar. Në sfondin e ndërtimeve dhe ndërhyrjeve përpërmirësim të izolimeve të objekteve ekzistuese nuk ka ndonjë përparim të duhur. Mungesa e sipërfaqeve të gjelbëra dhe dominim i ndërtimeve të forta pa respektuar kriterin në fjalë ngelin sfidë që vështirë mund të riparohen.

Problemet ekzistuese, dhe jo vetëm këto që u përmendën, kërkojnë një vetëdijësim institucional individual për të krijuar sadopak kushte më të pranueshme për një mirëqenje modeste në kryeqytetin e Kosovës. Akoma po dominon logjika e mbajtjes së gjendjes status quo me arsyetim se zgjidhja e problemeve mjedisore është i kushtueshëm dhe jo profitabil. Në fakt kjo sintagmë është një paradoks i patolerueshëm që po e shton çmimin e sanimit të pasojave (sëmundjeve) pa eliminuar shkaktarët e tyre. Qyteti pa lumenjë, qofshin ata edhe të vegjël (Vellusha dhe Prishtina), po zhvillohet në aglomerat të thatë, me ndërtesa të shumta dhe planifikime të pakoordinuara me konceptin e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të popullatës. Për këtë moment gjendja në Prishtinë reflekton si jo në përputhje me parimet e Zhvillimit të qëndrueshëm: zhvillim ekonomik, përkujdesje sociale dhe ruajtje të mjedisit (shëndetit).

6. 2. Problemet e Identifikuara mjedisore

Zhvillimi ekonomik i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numrit të ndërmarrjeve operuese, sirrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomikë është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit si në ajër, ujë dhe në tokë. Mungesa e filtrave në oxhaqet e operatorëve ekonomik, lirimi i gazrave të ndryshme nga gjeneratorët (numri i përdorimit të tyre momentalisht në Prishtinë është mjaft i madh), ndikon në ndotjen e ajrit. Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza komunale dhe industriale ka ndikim në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Deponitë komunale, industriale, mbeturinat mlike dhe të automjeteve, si dhe shkarkimi i ujërave të zeza individuale dhe industriale, janë burim i ndotjes.



Harta 12. Shkalla e ndotjes ne Kosovë

Fig. 7 Resurset natyrore dhe ndotja e mjedisit

Lista e problemeve mjedisore nuk duhet të përfshijë vetëm shqetësimet aktuale por edhe problemet e së ardhmes (zhvillimi ekonomik)

- ✓ Ndikimi i madh i trafikut në cilësi të ajrit
- ✓ Trafik i dendur . Makinat e vjetra dhe jofunksionale te transportit publik. Intensitet i lartë i makinave në brendësi të qytetit
- ✓ Ndotje e lartë e ajrit në brendi të qytetit
- ✓ Rrezikim i shëndetit të popullatës

- ✓ Perkeqësim i gjendjes së ndërtesave të banimit dhe kosto e lartë e mirëmbajtjes së tyre;
- ✓ Kosto e lartë e kujdesit shëndetësor, sëmundje që ndërlidhen me cilësinë e ajrit (bronhiti ,alergjitë endryshme)
- ✓ Mungesa e sistemit të ngrohjes nga ngrohtorja e qytetit
- ✓ Nuk ka lidhje të furnizimit me gaz natyror
- ✓ Monitorim i mangët i cilësisë së ajrit (benzeni , mni, mlet e rënda, komponimet organike të avullueshme, radioaktiviteti , zhurma etj)
- ✓ Ujërat e zeza
- ✓ Mbulueshmëri e ulët me sistem të kanalizimit, mungesa e trajtimit të ujërave
- ✓ Mungesa e monitorimit të cilësisë së ujërave të zeza (detergjentet , sapunet , vajërat, pesticidet , mlete rënda, radioaktiviteti etj)
- ✓ Nuk dihet për ujëra nëntokësore
- ✓ Mungesa e ujit të pijes në cilësi dhe sasi
- ✓ Mungesa e kadastrit të ndotjes së mjedisit nga ndërmarrjet prodhuese
- ✓ Kontrollë e dobët të Lejeve Ujore dhe Pëlqimeve Mjedisore
- ✓ Mbeturinat (komunale, komerciale , farmaceutike, materiet e rrezikshme, makinat e vjetra, gomat e përdorura etj)
- ✓ Sistem jo efikas i grumbullimit të mbeturinave nga amvisëritë
- ✓ Numër jo i mjaftueshëm i kontenerëve
- ✓ Deponitë e vogla ilegale
- ✓ Mungesa e sistemit të trajtimit të mbetjeve
- ✓ Zhurma
- ✓ Antenat e operatorëve telefonik dhe përdoruesve tjerë
- ✓ Gjelbërim jo i mjaftueshëm

6.3. Popullsia dhe Shëndeti

Pas luftës, numri i banorëve në Prishtinë është rritur në mënyrë të vullshme. Dëmet e rënda të luftës në zonat rurale e kanë penguar një pjesë të madhe të popullsisë që të kthehet në shtëpitë e tyre të shkatërruara. Një gjë e tillë shkaktoi zhvendosjen e tyre gjatë kohës së luftës dhe menjëherë pas saj, prandaj strehimi i familjeve ishte prioriteti më i lartë.

Në mungesë të legjislacionit të duhur, shtëpitë ndërtoheshin në mënyrë individuale dhe pa nxjerrjen e lejeve zyrtare të çfarëdo lloji për ndërtim. Një gjë e tillë, së paku për një kohë të shkurtër, nuk është penguar nga autoritetet dhe pjesërisht, kjo ishte konsideruar si pjesë e procesit të rindërtimit të pasluftës. Mirëpo edhe më vonë, kanë vazhduar ndërtimet pa leje dhe shumë prej tyre dolën si të padëshirueshme nga pikëvështrimi i rregulloreve të planifikimit. Vlerësimi për numrin e ndërtimeve pa leje në Prishtinë është prej 3.000-5.000, përfshirë këtu edhe mbindërtimet në ndërtesat e larta të banimit, të cilat janë ndërtuar pa leje planifikimi apo ndërtimi. Që prej vitit 2000, në Kosovë janë bërë gjithsej 15.000 ndërtime pa leje (MMPH 2002).

Rezultati i këtyre aktiviteteve të ndërtimit është i dyshimtë, si nga aspekti i kualitetit teknik dhe standardeve të sigurisë, ashtu edhe nga ai i krijimit të strukturave të qëndrueshme urbane, të cilat duhet të jenë funksionale për qendrën urbane të Kosovës në dekadat që do të vijnë.

Natyrisht, këto ndërtime të paplanifikuara janë të bëra kryesisht si pjesë e vrazhdë e ndërtimit (skeleti dhe muret), punë ndërtimore këto të cilat kërkojnë shkathtësi të vogla profesionale dhe investime modeste të kapitalit. Një pjesë substanciale e ndërtimeve të pasluftës ende nuk është përfunduar; punët që kanë mbetur për t'u kryer janë shtyer për më vonë. Ka shumë shtëpi të cilat janë të pabanueshme tërësisht ose pjesërisht, e që do të mund të shfrytëzoheshin më mirë nga pronarët e vet ose do të mund të vesheshin në treg në një të ardhme të afërt, duke e rritur kështu fondin e përgjithshëm të banimit.

Komuna e Prishtinës – mbi 900 banorë/km², ndërkohë që rajonet më të pabanuara janë viset malore dhe kodrinore me dendësi përafërsisht 50 banorë/km². Për përcaktimin e profilit demografik të zonës urbane të Prishtinës në planifikimet e mëparme ishte sfidë kryesore mungesa e shënimeve relevante dhe të besueshme, mungesa e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave në periudhën pas vitit 1981. Të gjitha përfundimet e deritanishme demografike ishin të bazuara në vlerësime, përderisa “Regjistrimi i vitit 2011” ofron informacione demografike në nivel të komunave dhe qendrave urbane, të cilat ndryshojnë nga trendet e deri tanishme bazuar dhe në rezultatet e implementimit të metodologjisë evropiane, të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave

Tabela 7. Indikatorët themelor demografik (pa përfshirë zonën e zgjeruar urbane)

z	Popullsia Kosova	Ekonomi familjare Kosova	Popullsia Komuna e Prishtinës	Ekonomi familjare Komuna e Prishtinës	Popullsia ne Prishtine (qyteti)	Ekonomi familjare Prishtinë (qyteti)
1948	733.132	115.292	44.324	8.000	19.631	4.667
1953	816.012	127.012	51.690	9.452	24.081	5.634
1961	964.084	152.606	70.116	13.706	38.593	9.059
1971	1.243.771	188.116	109.273	19.928	69.514	14.813
1981	1.584.440	228.884	148.656	26.721	108.083	21.017
1991 ⁸	1.956.196	289.246	199.654	35.974	155.499	29.642
2011 ⁹	1.733.872	295.070	198.214	40.292	144.677	31.105


Kujdesi shëndetësor në Kosovë është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa në nivelin komunal, nën përgjegjësinë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Sektori i shëndetësisë në Prishtinë është i mbuluar nga 1- QKMF dhe 15 QMF si dhe nga QKUK-ja. Në 15 QMF që funksionojnë në qytetin e Prishtinës shërbimet janë të ndryshme ndërsa numri i personelit është 484 persona,

Tabela 8. Supozimet e eksperteve dhe të dhënat zyrtare lidhur me Komunen e Prishtinës

Nr.	Burimi i të dhënave	Numri i banorëve			Baza
		Zona urbane	Komuna	Kosova	
1	ESI,1999	280.000		1.700.000	Indikatorë të ndryshëm specifik
	IMG,pas luftës së vitit 1999	283.00	338.000		Të dhënat e marra nga administrate locale,të pakontrolluara nga IMG
2	Komuna e Prishtinës	320.000 385.000			e panjohur
3	UNMIK/ESTAP/ Studimet e Bankës Botërore		502.000	2.073.000	(vlerësimi pë 2000)
4	ESK 2003			2.338.000	Shtimi në Kosovë 35.000-40.000 persona/vit
5	ESK 1981	111.480	150.000		Të dhënat nga regjistrimi, të vlerësuara si të qëndrueshme
6	ESK 1991		200.000	1.956.000	Të dhënat nga regjistrimi I fundit I vitit 1991.Të vlerësuara si të dyshimta
7	OSCE, 2000		545.000	2.364.000	Extrapolimimi I nivelit të rritjes së popullsisë së dikurshme në Kosovë prej 2%/vit
8	Sypozimet e Planit Strategjik	350.000	420.000		Diskutimi me ekspertë

Aktualisht, Prishtina nuk ka spital të qytetit, përderisa këtë funksion e kryen Qendra Klinike Universitare, e cila ofron shërbime të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës - gjindet në pjesën jugore të qytetit dhe përbëhet nga 29 klinika, me gjithsejt 1859 shtretër apo 1shtrat/103 1 shtrat/banorw tw qytetit tw Prishtinës. QKUK i ofron 1 mjek specialist për 285 banorë dhe 1 teknik mjekësor për 85 banorë. Në Prishtinë gjithashtu funksionon Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale



Harta 13. Objektet shëndetësore

6.4. Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e qytetarëve relevante për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisorë të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Kapaciteti mjedisor i zonës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisorë. Dëndësia e madhe e popullsisë, zhvillimi pa plan i zonave të banimit, ulja e hapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, perkeqesimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarte, shpenzime të larta të shoqërsisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Tabela 9..Shërbimet që mbulohen nga QKMF dhe QMF

Mjekësia familjare	
Shërbimi i pediatriisë	
Laboratori	
Shërbimi i dermatologjisë	
Shërbimi i vaksinimit	
Shërbimi i stomatologjisë	
Mjekësia familjare	
Ro kabineti	
Laboratoriumi	Mjekësia familjare
Shërbimi Antituberkular	Shërbimi i pediatriisë
Shërbimi specialistik	Laboratori
Mjekësia e punës	Shërbimi kronik
Shërbimi i pediatriisë	Shërbimi i dermatologjisë
Shërbimi Gjinekologjisë	Shërbimi i vaksinimit
Shërbimi i vaksinimit	Shërbimi i stomatologjisë
Administrata	Shërbimi internistik
Shërbimi teknik	Shërbimi i gjinekologjisë
Autoparku	
Barnatorja	RO – kabineti

6.5. Ceshtje Ekzistuese Mjedisore të Lidhura me Popullsine dhe Shëndetin

Një gamë çështjesh, si më poshtë, janë identifikuar për shëndetin në tërësi: Inkurajimi i çvendosjes së ndërtimeve në periferi të Qytetit, në zona paraprakisht të studjuara dhe mbështetje me infrastrukturë të nevojshme, sidomos kopshte, shkolla dhe qendra shëndetësore; marrja në konsideratë e efekteve kumulative të zhvillimeve në zonat për rreth Prishtinës dhe bashkeveprimi koherent me planet e zhvillimit të këtyre njësive;

Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në zona me densitet të lartë (Prishtina dhe Periferia dhe me gjërë);

Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave; Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale;

Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë; Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen; Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut.

Ndërtimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave të zeza si dhe menaxhimi i mbetjeve urbane.

7. MJEDISI FIZIK

7.1. Çështje Mjedisore që Lidhen me Mjedisin Fizik

Struktura Urbane e qytetit të Prishtinës kaloi nëpër faza të ristrukturimit, të ndikuara nga veprimet e ndryshme historike, politike, kulturore, sociale dhe ekonomike. Periudha e pas vitit 1999 karakterizohet me një tendencë spontane të zhvillimit të nxitur nga iniciativa private në ndërtimin e objekteve afariste, banesore dhe të lokaleve të përkohshme, të cilat kanë bërë qësipërfaqet e lira të degradohen pothuaj në tërësi. Ndërtimi i shtëpive individuale në mënyrë ilegale ka rezultuar degradim të strukturës urbane dhe me një rritje të paplanifikuar të qytetit të Prishtinës. Këto zona urbane dhe pjesët fqinje të zonave rurale janë zhvilluar në lagje dhe vendbanime të dendura, pa infrastrukturë teknike komunale dhe si të tilla kanë krijuar pengesa, të cilat e godasin rritjen e mëtejme të strukturuar të qytetit. Përgatitjet për zhvillimin e mëtejme të qytetit të Prishtinës janë bërë sipas kërkesave të shoqërive moderne evropiane dhe në funksion të përmbushjes së kërkesave për tokë ndërtimore me përmbajtje e infrastrukturë të duhur. Në këtë drejtim, janë bërë përpjekje të vazhdueshme në grumbullimin dhe vlerësimin e informatave themelore, në bazë të së cilave është krijuar një bazë e fortë për hartimin e strategjisë zhvillimore urbane të Prishtinës.

Hapësirat ekzistuese të lira në Prishtinë nuk janë të mirëmbajtura, shpesh janë jot ë qasshme dhe me me ndërlidhje jo të mira. Nuk janë të mjaftueshme hapësirat e lira në qytet, sidomos në zonat qendrore, hapësirë në të cilën vendtubim me të tjerë me funksione si:


- Hapësira publike si zonë e zhvillimit të veprimtarive ekonomike – tregti dhe shërbime.
- Hapësira publike si hapësirë e kulturës dhe ngjarjeve publike
- Hapësira publike si hapësirë e rekreacionit
- Hapësira publike si hapësirë reprezentative.

7.2. Zonimi i Prishtinës

Ndarjen territoriale të Prishtinës e ka përcjellë llojllojshmëria dhe fizionomia e saj e ndërlikuar. Traditat historike ishin si bazë për ndarjen territoriale të qytetit në mënyrë që t'u mundësohet qytetëve që të ndjehen sa më natyral në tërësitë e caktuara të tyre të cilat ndodhen gjatë historisë, me karakteristika të ndërtimit, me simbole urbane, me vende specifike të grumbullimit të banorëve etj. Në vitin 1981, Prishtina kishte 115.217 banorë me 26,721 ekonomi familjare dhe me dendësi më e madhe ishte në zonën "Qendra",

Tabela 10. Të dhënat për numrin e ekonomive familjare, popullsinë dhe madhësinë e familjes

Viti	Ekonomitë Familjare		Popullsia		Madhësia e Familjes (Numri i antarëve në EF)	
	Komuna	VendbanimetUrbane	Komuna	VendbanimetUrbane	Komuna	VendbanimetUrbane
1948	8000	4969	44324	21709	5.5	4.4
1953	9452	6041	51690	26589	5.5	4.4
1961	13706	9642	70116	41889	5.1	4.3
1971	19928	15563	105273	74132	5.3	4.8
1981	26721	22079	148656	115217	5.6	5.2
1991	35974	30982	199654	164151	5.5	5.3
2011	40798	37196	198053	176103	4.9	4.7



Harta 14. Zonat Katastrale të Prishtinës

Qyteti i Prishtinës përbëhet prej tri strukturave të ndryshme urbane:

- Pjesa e vjetër e qytetit - Zona historike e Prishtinës, e cila ende e ka të ruajtur indin e vjetër të rrugëve, por që nuk i ka të ruajtura shumë nga strukturat e vjetra, të cilat fatkeqësisht, dita ditës po zëvendësohen me struktura të reja duke i humbur karakterin historic dhe identitetin e kësaj zone porse dhe të qytetit të Prishtinës në tërësi.
- Pjesët urbane të qytetit me struktura komplekse shoqërore (banesore, publike dhe ekonomike), të cilat janë zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore, dhe të cilat kryesisht janë të koncentruara rreth e përfaqë pjesës së vjetër të qytetit, në qendër dhe në pjesën jugore të qytetit;
- Pjesët suburbane të qytetit, të shpërndara nëpër periferi të qytetit, të cilat përbëhen prej strukturave kryesisht të kombinuara të karakterit të banimit të kombinuara me destinime dhe ekonomike e komerciale, të cilat morën hov në periudhën e pasluftës së vitit 1999, të inicuar nga sektori privat.

Prishtina ka pak hapësira të lira. Përveç parkut të qytetit, disa sipërfaqeve të gjelbra dhe parqeve të vogla në lagjet e banimit kolektiv, sheshet para disa ndërtesave publike, dhe bulevardit “Nënë Tereza”, hapësirat tjera potenciale janë ose të braktisura, ose fare të pazhvilluara.

Në kohët e fundit është i dukshëm migrimi i një grupi të banorëve të qytetit me status më të lartë social në vendbanimet përreth e cila është shenjë e rritjes së shkallës së urbanizimit si dhe tërheqjes në zona suburbane. Një pjesë e migrameve është rezultat i

shfrytëzimit të objekteve sekondare të banimit për banim të përsershëm, si zgjidhje të problemit të banimit për familje.

Kushte e luftës së fundit në Kosovë gjatë vitit 1999 e kanë kushtëzuar edhe më shumë procesin emigrimit gjë që më së shumti ka ndikuar në rritjen e përgjithshme të numrit të banorëve në Prishtinë. Struktura e të punësuarëve është e ndryshueshme. Në Prishtinë dominojnë të punësuaritë në Institucionet Publike në relacion me Kosovë, derisa në qytetin e Prishtinës bujqësia individuale është më pak e theksuar. Prishtina në kuadër të Kosovës është pikësynimi më i theksuar i migrimeve ditore nga vendet e afërta apo nga vendet më të largëta të Kosovës. Sipas regjistrimit të vitit 1981 (1987) në qytetin e Prishtinës, në sektorin shoqëror ishin të punësuar 28, 584 persona. Qyteti i Prishtinës ka mjaft ndikim në zhvillimin e turizmit të Kosovës. Këto hapësira gjatë vitit 2011 janë vizituar dhe shfrytëzuar nga 32 245 vizitorë. Qyteti i Prishtinës ka 1372 ha tokë bujqësore (në pjesën lindore dhe perëndimore). Ndërlidhja e zhvillimit të qytetit dhe rrethinës së ngushtë dhe të gjerë, posaçërisht nga aspekti i punësimit dhe vendeve të punës, kërkon zhvillim më të harmonizuar dhe integral të qytetit dhe rrethinës. Potencialet turistike të rrethinës së qytetit shfrytëzohen më pak se mundësitë reale, meqë duhet të kemi kujdes për arkitekturën rurale dhe traditat.

7.3. Natyra dhe Biodiversiteti

Qyteti i Prishtinës kufizohet në pjesën verilindore me parkun e Gërmisë e cila me status është park regional. Gjindet në pjesën veri-lindore të Kosovës (Prishtina) dhe mbulon një sipërfaqe prej 62 km². Kufiri i Gërmisë kalon nga “Kodra e Vreshtave” në perëndim dhe vazhdon në “Kodren e Mirdites”, deri në Ajvali dhe lumin e Gracanices. Kufiri jugor kalon në lumin e Gracanices, deri në vendin ku bashkohet me lumin Busia, vazhdon në fshatin Mramor dhe Butos, deri tek lumi i Prishtinës që përfaqëson kufirin verior të kësaj zone malore. Pjesa më e lartë e Gërmisë është “Maja e Butovcit” me lartësi mbi dre prej 1050 m. Gjeomorfologjia e kësaj zone është e strukturuar nga kodra me lartësi të ndryshme, që ndahen në lugina e lumenj. Në këtë zonë dallohet lugina e lumit Vellusha, burimi I të cilit ndodhet në pjesën perëndimore të Butovcit dhe përfaqëson pjesën me karakteristike me lartësi mbidre me shume se 1000 m dhe gjatësi të lugines prej 8 km. Kjo zonë ndodhet midis lumit të Prishtinës në veri dhe liqenit të Badovcit, duke përfaqësuar duke përfaqësuar një hidrologji të lumenjve: Prishtevkë, Badoc dhe Vellushë. Përndryshe në Gërmie ekzistojnë burime të tjera të vogla të ujit të cilat gjatë kohës së verës thahen. Kohët e fundit uji i këtyre burimeve është i lidhur në një rrjet i cili përfundon në pishinën e Gërmisë. Në 1966 u vendos që një pjesë e maleve masive të Gërmisë të deklarohet si “Pyll për piknik”. Në 1987, asambleja komunale e Prishtinës vendosi ta marrë Gërmien në mbrojtje si “Park rajonal i Gërmisë”. Me këtë vendim u mbrojt zona e cila mbulon një sipërfaqe prej 1.126.01 ha. Ky park menaxhohet nga “Hortikultura” ndërsa Instituti për mbrojtjen e natyrës së Kosovës e monitoron parkun në mënyrë profesionale. Në këtë zonë ekzistojnë resurse të trashëgimisë natyrore dhe biodiversiteti i pasur, por menaxhimi me këto resurse natyrore nuk është i kënaqshëm..



Harta 15. Zona e Gjelberimit dhe hapësirat gjelbëruese

7.4. Speciet e zbuluara

Kompleksiteti i bio tipeve natyrore te Germise siguron kushte te mira per nje numer te madh speciesh.

Sipas kerkimeve te bera deri tani, ne zonen e Germise identifikohen: 5 specie amfibe, 7 specie zvarranike, 19 specie gjitare, dhe 30 specie te zogjve. Gjithashtu, jane identifikuar nje numer i madh i insekteve ne kete zone. Fatkeqesisht, raportet me te fundit nga Germia jane shqetesuese pasi qe nje sere speciesh jane zhdukur. Zogjtë: Accipiter nisus, Buteo buteo, Luscinia megarhynchos, Turdus merula, Emberiza calandra. Mammals: Talpa europaea, Microtus arvalis, Spalax leucodon, Apodemus sylvaticus, Myoxus glis. Kafshë të egra: ujku, derri egër, kitra, dhelpra, lepuri etj.

7.5. Çështje mjedisore të lidhura me Biodiversitetin

Ka mjaft kërcënime potenciale në manaxhimin e biodiversitetit, florës dhe faunës dhe lidhen së pari me densitetin e lartë të popullsisë dhe zhvillimet e dekadave të fundit të qytetit të Prishtinës. Çështjet në vijim janë identifikuar në planin tjera si shqetësime strategjike:

Ekosistemet ujore janë të fragmentuara, të degraduara dhe, siç janë, kanë humbur habitate për specie të rëndësishme të faunës. Gjëndja e tanishme nuk siguron dot nivele të pranueshme të habitateve natyrorë;

Rritja e volumeve të ujit të rrëshqitshëm sipërfaqësor për pasojë të betonimeve massive në zonën urbane duke e bërë truallin nga i përshkueshëm në të pa përshkueshëm. Kjo mund të rritë erozionin duke shkaktuar humbje direkte të habitateve; lëvizje të lirë natyrore të qenieve të gjalla duke përfshirë bimët dhe shtazet.

Masa për të ruajtur biodiversitetin duke i marrë në konsideratë, në fazat e herëshme, në plane të reja zhvillimi;

Kordinimi me njësi të tjera fqinje të pushtetit vendor me qëllim sigurimin e një brezi të gjelbërt parallel me zhvillimin urban në kryeqytet për të siguruar lidhjen e habitateve (midis parkut regional Gërmia dhe Hapësirave tjera gjelbëruese të Prishtinës.


Mungesa e parqeve private të cilët duhet të nxiten si biznese dhe përmirsuese të ndjeshme habitateve ndërmjet zonave urbane.

7.6. Shfrytëzimi i Tokës

Bazuar në informatat (raportet) nga zyrtarët kadastral, hartat kadastrale, ortofoto dhe nga të dhënat e mbledhura në terren shfrytëzimi i tokës në zonën urbane të Prishtinës është paraqitur në grafikun dhe hartën në vijim:

Tabela 11 . shfrytëzimit të tokave

	Bibliotekat	0.89	0.01%
	Kisha	4.39	0.06%
	Xhami	2.74	0.04%
	Policia	1.45	0.02%
	Posta	1.77	0.02%
	Konvikte	4.47	0.06%
Sip. e gjelbër	Pyje	1061	13.66%
	Park	916.16	11.79%
	Sip . E Gjelbëruar	594.36	7.65%
	Djerrina	311	4.00%
	Shkurre	358.19	4.61%
	Tokë Bujqësore	1372.96	17.67%
	Tokë jo Bujqësore	370.1	4.76%
	Pjesë e Liqenit	5.45	0.07%
	Sip. Sportive	17.91	0.23%
	Zonë Rekreative	15.92	0.20%
Sip. specifike	Trafo	7.46	0.10%
	Zonë Ushtarake	104.23	1.34%
	Varreza	37.42	0.48%
Sip. e transportit	Sip. Rrugore dhe hekurudhore	231	2.97%
	Totali	7768.76	100.00%



Harta 16. E shfrytëzimit të tokave

1. Sipërfaqja e ndërtuar është 2365.6 Ha ose 30.45% të sipërfaqes

Zona e banimit ka 2011.58 Ha, karakterizohet me dominim të banimit individual. Rreth 23.17% është banim individual (1800 Ha) dhe 2.72 % është banim shumëbanesor (211.58 Ha) pjesërisht me afarizëm.

Zona Ekonomike; zë një sipërfaqe 217.94 ha. ose 2.81 % të sipërfaqes së ndërtuar, karakterizohet me dominim të industrisë

Institucionet e arsimit zënë një sipërfaqe prej 34.7 Ha ose 0.45% të sipërfaqes së ndërtuar

Institucionet shëndetësore zënë sipërfaqe prej 33.9 Ha ose 0.44% të sipërfaqes së ndërtuar

Institucionet administrative zënë sipërfaqe prej 50.08 Ha ose 0.64% të sipërfaqes së ndërtuar

Objektet e kultit zënë sipërfaqe prej 7.13 Ha ose 0.10% të sipërfaqes së ndërtuar

2. Sipërfaqet e gjelbërta zënë 5023.05 Ha ose 64.06% të sipërfaqes

3. Sipërfaqet specifike 149.11 Ha ose 1.92 % të sipërfaqes

4. Sipërfaqet e transportit dhe trafikut zënë sipërfaqe 231 Ha ose 2.97 % të sipërfaqes

Pronësia në zonën urbane të Prishtinës grupohet në:

Pronësi shoqërore 2695.21 Ha ose 34.7%

Pronësi private 5073.48 Ha ose 65.3 %

Numri i përgjithshëm i ngastrave është 25524 prej të cilave 3437 janë ngastra shoqërore ndërsa 22087 janë ngastra private.

7.7. Çështje Mjedisore që Lidhen me Përdorimin e Tokës

- Përdorimi urban i tokës është i lartë dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbër është i disfavorshem duke tejkaluar normat europiane dhe në nivel vendi si Kosovë;

- Planifikimi i zonës urbane nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste të jashtëzakonshme dhe duke i rikompensuar ato;

Duke pasur parasysh keto specifika, duhet të paraqiten masa të pershatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, ku sipas standardeve të BE- për çdo koke banori nevojiten nga 9 m² sipërfaqe të gjelbër. Për më tepër, duhet respektuar kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin urban, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe të infrastruktures.

7.8. Mjedis i Ndërtuar dhe Kultura

Prishtina zë pozitë të rëndësishme në Evropën Juglindore. Në juglindje kufizohet me vargmalet e Gallapit (Mons Argentaria), të pasura më xehe të mleve fisnike, bimësi e faunë, kurse në jugperëndim hapet rrafshi fushor me tokë të butë pjellore për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë.

Fosilet e Mamutit (mamontus primigenius) të gjetura në Prishtinë dëshmojnë për krijimin e kushteve gjeoklimatike të jetesës së njeriut së paku në paleolitin e vonë.

Neoliti (7000 – 3500 para Krishti).

Eneolitiku (3500 – 2600 para Krishti)

Epoka e bronzit (2600 – 1000 p.Kr.).

Epoka e hekurit (shek. IX – V p. Kr.),

Epoka dardane e hekurit të hershem në komunën e Prishtinës, kryesisht njihet nga vendbanime kodrinore (kështjella) shumështrësore, të zbuluara në Kolovicë dhe Sofali. Në vitet e 60-ta dhe 70-ta, qendra urbane e Prishtinës i ishte nënshtruar shkatërrimit të planifikuar.

Ndërtesat historike, kryesisht të banimit, ishin rrënuar dhe zëvendësuar me ndërtime të reja të një përmase krejtësisht tjetërfare, sipas frymës moderniste që ishte predominante në atë kohë në Evropë.

Ndërtesat që e mbijetuan atë kohë të zhvillimit të qytetit, janë transformuar në vitet e pasluftës pa ndonjë udhëzim të planifikimit urban. Edhe pse rindërtimi është bërë brenda kornizave të vendndodhjes së strukturës së vjetër, vëllimi dhe madhësia e ndërtesave të reja shpesh i kanë cenuar parimet më themelore të përmbushjes së standardeve të pohuara, të ajrosjes natyrore dhe të ndriçimit (insolimit).

Sot, vetëm disa ndërtesa me materiale origjinale ndërtimore (murë argjile, mbulesë prej qeramidheve dhe traje të drurit) kanë mbijetuar pa ndonjë dëmtim ose modifikim të formës dhe shtrirjes së tyre origjinale.

Më 1976, Komuna e Prishtinës hartoi Planin rregullues për zonën e vjetër të qytetit të Prishtinës - Zona Historike e Prishtinës - me qëllim të ruajtjes së vëllimit të strukturave të vjetra, si dhe për të rekomanduar përdorimin e materialeve ndërtimore tradicionale. Fatkeqësisht, implementimi i këtij Plani ishte i ndikuar nga rrethanat që pasuan më vonë.

Në këtë zonë janë evidentuar objekte të arkitekturës, duke përfshirë objekte kulturi (xhami, teqe, kisha etj.) shtëpi banimi të arkitekturës qytet, varreza, varrezat hebraike në Velani dhe Kalabari, varrezat e LNC-së, varrezat e Luftës së vitit 1999, dhe varri i presidentit Rugova në Breg të Diellit. Në Gazimestan ndodhet Tyrbja e Bajraktarëve nga shek. XVII.

7.9. Cilësia e Ajrit

Deri në vitin 2010, cilësia e ajrit në qytetin e Prishtinës, është vlerësuar visuelisht, përmes shqisave të fymëmarres apo përmes disa matjeve të pakta të parametrave që duhet të monitorohen. Që nga viti 2008 deri në vitin 2012 MMPH përmes investimeve direkte nga buxheti i saj dhe ndihmave nga Komisioni Evropian, Prishtina sot ka një sistem relativisht të kënaqshëm të monitorimit të cilësisë së ajrit. Për nga numri i stacioneve monitoruese, (4 në total, 2 jashtë funksionit) Prishtina ka plotësuar një ndër kriteret për stacione të tilla, por jo edhe numrin e parametrave që kërkohen nga BE dhe Organizata botërore e shëndetësisë. Tani monitorohen 5 parametra, ndërkohe që BE kërkon matjen e së paku 12 parametrave, ndër të cilët edhe benzeni, metalet të rënda etj. Në Prishtinë, përmes dy stacioneve monitoruese monitorohen këta parametra: NO_x, SO₂, PM₁₀/PM_{2.5}, ozoni dhe CO. Kontribuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit janë burimet statike dhe ato të lëvizshme. Qyteti ndikohet kryesisht nga transporti i brendshëm dhe ai transit përgjatë magjistrave kryesore. Të gjitha rrugët janë të stërngarkuara me numër të madh të automjeteve nga të gjitha llojet, ndërsa kur përdoret karburant me cilësi jo të mirë dhe makina të vjetruara nikimi në përkeqësim të cilësisë së ajrit vjen duke u shtuar. Ndotja e ajrit shumëfishohet e ndihmuar edhe nga amvisnitë. Ngrohtorja e qytetit konsiderohet ndër ndotësit më të mëdhenj për shkak të sasive të mëdha të mazutit që përdoret në kazantore gjatë sezonit të ngrohjes.

Harta 17. Stacionet ekzistuese të monitorimit të ajrit në Prishtinë



Në qytetin e Prishtinës, problem të vaçantë paraqet prezenca e pluhurit, në formë të PM₁₀ dhe PM_{2.5}, vlerat e të cilëve parametra tejkalojnë Vlerat e Lejuara Maximale (VML), përderisa VML e lejuar është 40 µg/m³. Vërehet se koncentrimi më i lartë i ndotjes së ajrit me PM₁₀ ka qenë gjatë muajve të sezonit dimëror. Ozoni në shtresën e troposferës është formuar si rezultat i reaksioneve komplekse ndërmjet ndotësve primarë të prezantuar në atmosferë dhe rrezatimit diellor. Është pjesë e një serie të komponimeve oksiduese të cilat formojnë në atmosferë aerosol të quajtur “smog fotokimik”. Smogu fotokimik mund të formohet kryesisht në muajt e verës gjatë orëve të ditës nga ndotësit e emituar kryesisht nga automjetet siç janë oksidet e azotit, hidrokarburet jomnike etj. Tabela e më poshtme

tregon tejkalimet e pragut të informacionit dhe pragut të alarmit si dhe tejkalimin e mesatares ditore në stacionet Prishtinës- IHMK gjatë periudhës së monitorimit (2010, 2011). Prej shumë oksideve të azotit që paraqiten në ajër më të rëndësishmit janë: NO, NO₂, N₂O, etj. Emisioni i NO antropogjene është shumë domethënës, posaçërisht në zonat urbane dhe industriale sepse aty është i koncentruar më shumë. Sa i përket ndikimit të NO në materiale dhe vegjcion, eksperimentet kanë treguar që NO ndikon në zbehjen e ngjyrës së materialeve tekstile, shkakton korozion në materialet mlike, kurse në vegjcion ndikon në rënie të gjetheve. Eksperimentet kanë treguar se NO₂ është 4 herë më vdekjeprues se NO. Për këtë arsye edhe janë vendosur standardet e lejuara për NO₂ dhe rezultatet e matjeve në cilësinë e ajrit i referohen koncentrimin të NO₂.





Fig. 1. Vlerat mesataremujore të PM10 në stacionin monitories Rilindja dhe IHMK, 2010

8. Burimet Ujore

8.1. Burimet Ujore dhe Furnizimi me Ujë

Dikur Prishtina kishte dy lumenjë: Prishtevkën dhe Vellushën, të cilat sot nuk janë përmbi sipërfaqe, duke u shndërruar në kolektorë të ujërave të zeza.

Prishtina kishte një plan për trajtimin e ujërave të zeza, me objekt të ndërtuar përkatës, sipas metodologjisë së viteve “50-ta”. Ky objekt i trajtimit mekaniko-kimik i ujërave të qyteti të Prishtinës, sikur na përkujton nevojën imediate të inicimit të planifikimit të ndërtimit të objektit gjegjësisht me metodologji dhe teknologji moderne, bazuar në kriteret për qllime të tilla.



Harta 18. Rrjeti i kanalizimeve

Qyteti i Prishtinës ka sasi të limituara të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të cilat kryesisht janë të shpërndara në pjesët periferike. Një pjesë e vogël e sasisë së ujërave gjenden si ujëra nëntokësorë, psh në fushën e Pajtimit me sasi 50 l/sec dhe burimit të Gërmisë me sasi deri në 15 l/sec.

Rrjedhat ujore janë të pakta, përderisa në pjesën urbane janë lumenjtë e vegjël: Prishtina, dhe Vellusha, që grumbullojnë edhe rrjedhat ujore të prockave nga Lagja e Spitalit, e Matit dhe nga pjesa veriore/ Kodra e trimave dhe Shkabaj.

Lumenjtë Prishtina dhe Vellusha, në pjesën më të madhe të zonës urbane janë të mbuluar shërbejnë për grumbullimin e ujërave të shiut nga të gjitha pjesët urbane të Prishtinës. Burimet kryesore të ujit të pijes

mbeten liqenet akumuluese të Batllavës dhe Badovcit.

Liqeni i Batllavës – Ka vëllim prej 38 milion m³ ujë dhe furnizon qytetin e Prishtinës me 65%. Ky liqe paraqet resursin kryesor të ujit të pijes për territorin e Komunës së Prishtinës,

i ndërtuar në vitin 1960- 1963, fillimisht për furnizim me ujë teknik për kompleksin energjetik në Obiliq dhe më pas nga viti 1982 shëndrruar në resurs uhor për ujë të pijes për regionin e Prishtinës. Në Shajkovc (Alabnik) është e ndërtuar fabrika e përpunimit të ujit me kapacitet maksimal prej 900l/sec.

Liqeni i Badovcit – Ka vëllim prej 27 milion m³ dhe furnizon qytetin e Prishtinës me ujë me 35 %. I ndërtuar në vitin 1960 për furnizim me ujë të pijes ,ujtje dhe ujë teknik për minierën e Kishnicës. Nga viti 1980 ky liqen kryesisht përdoret për ujë të pijes për qytetin e Prishtinës dhe zonën periferike. Në Badovc është ndërtuar fabrika për përpunimin e ujit me kapacitet 400l/sec.



Foto 1 . Liqeni i Badovcit

Burimet nëntokesore të Kolevicës dhe burimi i Gërmisë paraqesin resurset natyrore prej të cilave është furnizuar Qyteti i Prishtinës në vitet 1950-1970. Burimet e Kolevices kanë kapacitet prej 50 l/sec. Në vitin 1982, pas ndërtimit të sistemit të Batllaves dhe rritjes së ndotjes nuk janë më funksion, përderisa burimi i Gërmisë me kapacitet prej 15l/sec, përdoret si furnizuesi kryesor i pishinës së Gërmisë.

Rezervuarët e ujit dhe Stacionet e Pompave - Prishtina ka konfiguracion të përshtatshëm përvendosjen e rezervarve. Qyteti i Prishtinës ka 6 rezervoarë me vëllim total prej 70.000 m³ dhe janë të paraqitura si në tabelën e mëposhtme: Rezervuarët janë të vendosura në pika kyqe që mbulojnë me furnizim zonat e caktuara të qytetit të Prishtinës. Zonat e presionit shtrihen prej 550 m/nd deri në 720 m/nd . Rezervuarët në total kanë një vëllim prej 70.000 m³ dhe janë: Pjesë e furnizimit me ujë të pijes, janë edhe stacionet e pompave që janë në pjesët e ndryshme të

Prishtinës. Stacionet kryesore të pompave janë:

Rrjeti shpërndarës përbëhet prej rrjetit primar dhe sekondar, ndërsa diametrat e rrjetit primarë janë nga Dn(80-1000) mm dhe rrjetit sekondar nga Dn(65-25)mm. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të ujit brenda zonës urbane është 450 km. Materialet janë: Azbest çimentoja, (A.C),PVC, Polietileni(PE) Hekuri daktil (DCI) dhe (CI) Gypat e zingruar(GI). Gypat datojnë nga vitet e 50-ta. Si pasojë e vjetërsisë ka dhe humbje relativisht të larta rreth 50% nga të cilat 35% janë humbje teknike dhe 15% humbje komerciale.

Menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe ujëra të zeza bëhet nga kompania publike “Ujësjellësi Rajonal Prishtina , e cila ofron shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në 8 Komuna. Me shërbime të ujit janë të kyqur rreth 97% të banorëve, ndërsa pjesa tjetër me

furnizim individual nga e puset. Pas vitit 1999 ishte sfidë furnizimi I rregullt me ujë të rregullt përmes sistemit të ujësjellësit, shkaku u l mungesës së ujit dhe humbjeve të larta të ujit gjatë sistemit. Sot ekzistojnë reduktime të planifikuara të ujit të pijes ku ndërprerjet e ujit jane 8-10 orë mbrenda 24 h. Numri i konsumatorve që faturohen në zonën urbane llogaritet të jetë rreth 55.000. Sasia totale e ujit që Distribuhet për zonën urbane është 850 l/sec ndërsa konsumi për kokë banori është 140 litra/ditë/banorë

8.2. Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm

Ka raste kur cilësia e ujit kompromentohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrat e zeza, për shkak të intersektimeve të shumta të tubacioneve të ujit të pishem me ato të ujrave të zeza);

Përdorimi për qëllime të tjera veç përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasitë e nevojshme për popullsinë;

Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 15 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfqësore për shkak të përshkueshmerisë së lartë të shtresave mbrojtëse.

Problemet evidente

Burime të pamjaftueshme ujore

Humbjet e larta të ujit të pijes

Reduktimet e theksuar të ujit

Mosmbrojtja e burimeve ujore – mosiplementimi i zonave mbrojtës

Infrastruktura e vjetruar e rrjetit të ujit dhe ujrave të ndotura

Mosrregullimi i rrjedhave ujore

Mostrajtimi i ujrave të ndotura

8.3. Menaxhimi i Mbeturinave

Rreth asgjësimit të mbeturinave, duhet të zhvillohen strategji të reja në mënyrë që të reduktohet sasia e mbeturinave, dhe së dyti, për ta kthyer procesin linear të shfrytëzimit, konvertimit, përdorimit dhe të asgjësimit, tipike për modelin tonë të zhvillimit ekonomik – në një proces i qarkullimi bazuar në riciklim edhe pse me vlerë ekonomike, duhet të zhvillohen PLVM dhe Planet lokale për administrimin e mbeturinave .

Për rrjetin hipografik PZHUpropozon përmirësimin e cilësisë së ujit, me heqjen graduale të mbeturinave të cilat ende ndikojnë në disa pjesë, dhe të bankave, me një program të veprimeve për secilin kanal që siguron rehabilitim të vlerave mjedisore dhe natyrore, duke forcuar aktivitete rekreative, pasurimi i biomasës buke mbjellur pemë dhe shkurre për të kompletuar skajet e peizazhit bujqësor, duke ruajtur elementet e mbetura historike të peizazhit. Matje të shumta kushtuar mbrojtjes së mjedisit (ruajtja e peizazhit, mbeturinat solide dhe përpunimin ujërave të humbura, politikat pylltarisë...) janë përmendur në paragrafet e mëhershme. Sidoqoftë, është e mundur të radhiten matjet e veçanta të mëposhtme: Për të reduktuar ndotjen akustike në zonat urbane duhet të ndiqen veprimet e duhura, dhe përmes ndërhyrjeve kushtuar pajisjeve dhe performancës së infrastrukturës, edhe nga ndërhyrjet direkte në burimet e zhurmës.

Për vendbanimet e reja, vlerësimi i ekspozimit të ndotjes akustike do të ndihmojë në çasje inovative në dizajn dhe konstrukcion.

Matjet për zbutjen e zhurmës, ku është e nevojshme, duhet të integrohen me mjedisin dhe të kontribuojnë në cilësinë e hapsirave urbane.

Për reduktimin e ndotjës së ajrit në ambientin urban, duhet të ndiqen veprat e duhura. Ndërhyrjet në vendbanimet e reja duhet të sigurojnë rritje të biomasës në zonat e gjelbërta, dhe të jenë në gjendje të absorbojnë ndotjen duke zvogëluar kështu përqendrimit.

8.4.Furnizimi me Energji

Energjia, në kushtet bashkëkohore, është një ndër resurset e pazëvendësueshme të zhvillimit ekonomik, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe mirëqenies sociale në përgjithësi.

Spektori energjetik tash për tash nuk është në gjendje të bëjë furnizimin me rrymë gjatë 24 orëve, gjë që bizneset dhe qytetarët e komunës janë të detyruar të bëjnë shpenzime shtesë duke përdorur gjeneratorë.Reduktimi I Energjisë Elektrike behet ne baze te te ashtuquajturit Plani ABC dhe pa ndonje paralajmerim adekuat. Bazuar ne burimet nga KEK-u nevojat per Energji Elektrike jane diku 320 MW gje qe ben te konkludojme se Furnizimi eshte ne limitin e kerkesave.

Sistemi i rrjetit elektro-energjetik nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e qytetarëve, nga se në shumicën e vendbanimeve të komunës ky sistem është i stërvjetëruar. Trafostacionet janë të kapacitetit të vogël.

Furnizimi i qytetit bëhet përmes 10 trafostacioneve:

TS-Prishtina -1, me 63+63 MVA - 2 trafo ; 110/35 KV,


TS- Prishtina -2, me 31.5+63 MVA - 2 trafo ; 110/10 KV,

TS-Prishtina -3, me 31.5+40 MVA - 2 trafo ;110/10 KV,

TS-Prishtina - 4 – 2 trafo 150 MVA ;220/110 kV

TS-Prishtina – 5, me 40+40 MVA - 2 trafo me kapacitet 110/20 KV,

si dhe 45 trafostacione të cilat furnizojnë me rrymë vendbanimet rurale, me kapacitet të pamjaftueshëm (35.6 MVA).



Harta 19. Shperndarja e Energjise elektrike per Qytetin e Prishtines –Skema njepolare

8.5. Problemet Enegetike me të cilat përballlet Prishtina

- Trafostacionet 35/10kv të gjitha janë të vjetra. Investohet vetëm në mirmbajtje dmth ndërrohen ndarësitë dhe ndërprerësitë e vjetër dhe zëvendësohen me të rinjë.
- Linjat 35kv, 10kv dhe pjesërisht 0.4kv janë të vjetra, shumica prej tyre të ndertuara para lufte. Të gjitha të mbingarkuara sidomos gjatë dimrit
- Trafostacionet 10(20)/0.4kv të mbingarkuara, pjesërisht edhe të mirmbajtura keq.
- Linjat 0.4kv me shtylla të vjetra dhe përques të mbingarkuar.
- Mosharmonizimi i ngarkesave te nevojshme dhe shperndarja asimetrike e fuqise
- Mosekzistimi i dokumentacionit adekuat teknik mbi gjendjen ekzistuese të furnizimit me energji elektrike te shpenzuesitë e fundit (Konstatim i nxjerrë në bazë të vizitës në lokacione të ndryshme të qytetit)
- Shperndarje asimetrike e ngakesave te shpenzuesitë e fundit dhe mospërshtatje e tyre Trafostacioneve furnizuese.

- Dyer të trafostacioneve të hapura dhe të pambrojtura. Kuadro të ndriqimit publik të vjetruara dhe të hapura, gjë që paraqet rrezik për qytetarët në aspektin e tensionit prekës të mundshëm në rast të kontaktit të njerëzve me to.
- Shtyllat e ndriqimit publik të koroduara dhe të pagalvanizuara
- Grumbullim i kabllave ABC (bistek) dhe linjave ajrore në shtylla druri pa ndonjë rregull të caktuar
- Gërshetimi i linjave ajrore me kablllo koaksiale të provajderëve të telekomunikacionit dhe televizionit pa ndonjë rregull të caktuar
- Në PTK pikë kritike është numri shumë i madh i fshatrave që nuk mbulohen me rrjet telefonik me tela.
- Gërshetimi i linjave të kabllave të bakrit me rrjetin energjetik dhe rrjetet e provajderëve tjerë të Telekomunikacionit.
- Mosharmonizimi i rrjetit kabllorik të ri me infrastrukturën e Qytetit
- Vendosja e parexistruar e antenave për telefoni mobile(BTS) nga provajderë të ndryshëm (jo në përputhshmëri me Autoritetet Komunale të KK Prishtinës)
- Vonesa në privatizim të KEK dhe PTK;
- Mosmundësi e veprimit nga PTK, shkak i rrugëve të ndërtimit të infrastrukturës rrugore, për shkak të vendosjes paralele të kabllave optike me rrugët.

8.6. Aktivitetet Ekonomike dhe Sociale

Ekonomia e Prishtinës, si dhe e gjithë Kosovës dhe e Evropës Jug Lindore (EJL), pësoi një goditje të fortë gjatë periudhës së tranzicionit drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Mbyllja e shumë ndërmarrjeve industriale shtetërore në fillimet e viteve „90 dhe mungesa e burimeve financiare solli rritje të papunësisë dhe situatë ekonomike në përgjithësi. Një situatë e tillë e përjetoi edhe Kosova gjithashtu, e pare në këndvështrimin mjedisor, mbyllja e shumë prej industrive zvogëloi edhe shkarkimet ndotëse në ajër, ujë dhe tokë dhe zhvillimet ekonomike në rajonin e Prishtinës, në vitet që pasuan, u përqendruan në aktivitetet tregtare, administrative dhe kulturore, dhe jo në industriale të mirefillta.

Nuk ka ndonjë studim të drejtpërdrejtë që të lidhë kushtet e mjedisit me aktivitetin ekonomik të Prishtinës. Megjithatë, nuk rezultoi që aktualisht aktivitetet industriale të cilat janë kryesisht të karakterit ushqimor dhe perpunues, të kenë krijuar probleme sinjifikante që lidhen me ndotjen e mjedisit.

Stabiliteti krijuar vitet e fundit në furnizimin e me energji elektrike gjithashtu, ka minimizuar edhe përdorimin e gjeneratorëve industrial, të cilët emetonin sasi të konsiderueshme gaze ndotëse, duke ju shtuar shkarkimeve të po të njëjtes natyre nga transporti.

Legjislacioni aktual për investitorët vendas dhe të huaj, në vecanti ai mjedisor, që në përgjithësi është i përafërt me atë të BE, parashikojnë të gjitha procedurat dhe masat për të siguruar që investimet për zhvillimin social ekonomik në Prishtinë ashtu si dhe në gjithë vendin, të mos demtojnë apo demtojnë mjedisin.

8.7. Analiza SWOT

SWOT analiza është instrument i skanimit përfundimtar të një dukurie apo vendi në kuptim të problemeve dhe mundësive për të ardhmen, në kontekst të ngushtë, pra brenda përbrenda problemit, porse dhe në kontekst më të gjërë të problemit së bashku me mundësi. Është përmbledhje e të gjitha problemeve të listuara për nga prioritetet, të cilat të bashkuara apo të shiquara në mënyrë sinkrone, mundësojnë hartimin e hapave të ardhshëm të synimeve, objektivave dhe projekteve.

Kjo fazë e analizave, në të kundërtën e asaj paraprake, synon drejt të ardhmes, përderisa është esenciale

për të arritur objektivat e paraqitur në vijim:

- Të vlerësohen përparësitë e kontekstit lokal
- Të minimizohen pikat e dobëta
- Të përfitohet nga mundësitë e prezentuara
- Të tentohet kundërshtimi i rreziqeve të ardhshme

Agrumente të Analizës SWOT - Mjedis

Përparsit

Dobësit

• Burime natyrore • Biodiversiteti i pasur me lloje të ndryshme ; • Rritje e interesit publik për mjedisin; • Mungesë e industrive që ndotin mjedisin në mënyrë intensive • Ekzistimi i një pjese të madhe të natyrës dhe pejsazhit të paprekur. • Regjioni i komunës së Prishtinës është i rrethuar me pyje me një hidrografi interesante, me prezencë të drunjëve me gjethe, Klimë e pershtatshme; • Prezenca e zonave natyrore të mbrojtura: Parku rajonal natyror i Gërmisë, i pasur me florë, vegjcion dhe faunë;	• Mungesë e sundimit të ligjit; • Ndotje e ajrit në zonat urbane / me trafik; • Mungesë e Impianteve te Trajtimit te Plehrave te ngurta dhe te ujerave te zeza; • Mungesë e financimeve për parqet; • Mungesa e aftësive mbi çështjet mjedisore; • Taksë e ulët mbi mjedisin; • Mungesa e hapësirave të hapura publike në zonat urbane; • Mungesë e Profesionistëve në fushën e Mjedisit • Nivel i ulët i ndërgjegjësimit / informimit; • Rrjet monitorues i papërshtatshëm • Administrim i dobët i mbeturinave dhe hedhje te pakontrolluar e tyre • Ndotje e ujit e shkaktuar nga mungesa e trajtimit të ujit, • mungesë e infrastruktures së duhur nëpër ndërtesa, • Ndotja e ajrit shkaktohet nga djegia e linjitit (KEK), nga trafiku i motorizuar (shume makina të vjetra), nga sistemi I ngrohjes qendrore me mazut (Termokos), veçanërisht në zonën urbane. • Humbje e tokës për te ndertimeve pa leje, ndërtimi i rrugëve dhe autostradave, erozioni, gërmim i Pakontrolluar i tokës. • Ndërtime të paligjshme në parkun e Gërmisë. • Mungesë e vetëdijësimit publik në aspektin e mbrojtjes së mjedisit.
--	---

Mundësit

Rreziqet

• Modernizimi i shërbimit meteorologjik; • Zhvillimi i informimit publik; • Impianteve te Trajtimit te Plehrave te ngurta dhe te ujerave te zeza Shfrytëzimi i biodiversitetit në mënyrë sensitive; • Ruajtja dhe menaxhimi i parqeve • Më shumë hapësira të hapura publike / xhepa parqesh; • Çat Kulmei të gjelbërta-Skema të llojit .Britania në lulëzim (sic eshte skema ne Angli .Britain in Bloom.) • Peizazh i mire dhe potencial mjedisor.	• Vazhdimi i shpërndarjes urbane; • Përkeqësimi i natyrës / mjedisit / biodiversitetit • Kërcënime të shëndetit prej mbeturinave johigjenike ujore dhe solide; • Menaxhim jo i mirë i turizmit; • Ndryshimi i klimës; • Mbipopullimi i qytetit • Termocentralet ekzistuese dhe të planifikuara dhe ndikimi i tyre në mjedis. • Vazhdimi i coptëzimit të hapësirave të hapura • Thatësira – konsiderohet si kërcënim për furnizimin me ujë gjatë sezonit të verës kur temperaturat janë më të larta
---	--

9. KRAHASIMI I ALTERNATIVAVE

9.1. Alternativa sipas Zgjerimit të "Planit të Qendrës"


Më 1969 është marrë vendimi me të cilin "Planin direktiv të trafikut dhe të dedikimit të sipërfaqeve të qytetit" e zëvendëson Planin i Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës, përderisa kurse PPU i vitit 1953 hiqet nga fuqia.

Më 1970, Enti për Zhvillimin Ekonomik dhe Shoqëror të Prishtinës hartoi "Programin Urbanistik të Qytetit të Prishtinës dhe të Vendbanimeve Periferike". Pasi përpjekjet për të gjetur ndonjë organizatë urbanistike, e cila do ta merrte përsipër hartimin e PPU-së, nuk dhanë fryt. Programi urbanistik i punuar, si përpjekje e bërë mbeti qëllim për vetvete, kurse pasqyra përcjellëse grafike e tij (sipas Ligjit –pjesë përbërëse e Programit) vetëm sillte huti në punën e shërbimit urbanistik të Komunës.

Me 1975, pas përgatitjeve dyvjeçare për fillimin e hartimit të PPU-së, u aprovua "Projekti i Detyrës për Hartimin Planit të Përgjithshëm Urbanistik të Prishtinës" dhe u mor vendimi për fillimin e hartimit të PPU-së (Fletorja zyrtare e KSAK" , nr"51/75) .7



Harta 20. Plan i përgjithshëm i Prishtinës 1986-2000



Harta 21. Plan strategjik i Prishtinës 2004-2012

Koncepti i dokumentit të aprovuar me modelin e procesit të hartimit të PPU-së, kishte për qëllim të vendosë bazat për fillimin e planifikimit dhe rregullimit të vazhdueshëm, të hapësirës së Prishtinës. Planifikimi i Prishtinës ishte përfshirë dhe me planet hapësinore të rendit më të lartë, Planin Hapësinor të KSAK-ut të vitit 1978 dhe Planin Hapësinor Rajonal të Kosovës për të cilin nuk ishte aprovuar nga Kuvendi I Komunës së Prishtinës.

Më 1988 është aprovuar Planin i Përgjithshëm i Prishtinës për periudhën deri në vitin 2000, për numër të banorëve 225.000 dhe me sipërfaqe prej 4335 ha.

Më 2004 është aprovuar Planin Strategjik i Prishtinës për periudhën deri në vitin 2020, për numër të banorëve 650.000 dhe me sipërfaqe prej 4335 ha.

Planin i përgjithshëm i Prishtinës 1986-2000 dhe Planin strategjik i Prishtinës 2004-2012, nuk ofruan një mundësi për planifikimin e territorit të zonës qendrore të qytetit. Ato

paraqesin nje rregullim estetik te qendres se qytetit, por me dyshime mbi mungesen e kriterëve apo arsyetimit per njollat zhvillimore te vecanta duke ndjekur kufinjte individuale te pronesise pa patur formule te menaxhimit te prones.

Planet e paraqitura nuk dhanë shumë zgjidhje per problemet madhore te qytetit dhe as per pritshmerine e rritjes demografike te qytetit. Ato nuk u shoqeruan me nje planifikim financiar te prioriteteve infrastrukture dhe as me burimet e financimeve. Nuk kishte asnje plan infrastrukture per zonen ne shqyrtim dhe nuk trajtoi as ceshtjet e parkimeve, transportit, energjise elektrike, ujesjellesit dhe kanalizimeve, etj. Këto Plane nuk u shoqerua as me hedhjen e te dhenave ne nje Sistem te Informacionit Gjeografik (GIS) per te mundesuar sakte si me te madhe dhe lehtesuar procesin e planifikimit te integruar. Ne menyre te ngjashme, nuk pati asnje forme te pjesemarrjes publike ne vendim-marrje pasi nuk u mbajt asnje degjese apo konsultim publik.

Megjithese ishte nje kerkese ligjore, Planet e sipër përmendura nuk u shoqeruan me Vleresim Strategjik Mjedisor (VSM), per pasoje komponenti mjedisor mungonte krejt dhe u la sipas gjykimit te planifikuesve te cilet propozuan zgjidhje estetike. Nuk pati kriteret e qarta dhe as nuk u shprehen elementet mjedisore te qenesishem qe duhej te kufizonin zhvillimin urban te qytetit.

Planet nuk pasur as suksese zbatimi.

Këto plane nuk ofruan ndonje vizion strategjik afatgjate per zhvillimin e qytetit, infrastrukturen e nevojshme, modelet e zhvillimit apo qofte dhe per trajtimin e ndertimeve ekzistuese.

9.2. Alternativa sipas Plani Zhvillimor Urban të Prishtinës

Plan Zhvillimor Urban 2013 – 2025, u iniciua nga Komuna e Prishtinës, për sa u përket pritjeve nga PZHUP, sipas vlerësimit janë shume te medha nga te gjithet aktoret ne kete proces:

Pronaret e tokave ne Prishtinë presin planin e ri qe te jete nje instrument i drejte ne zhvillimin korrekt te pronave te tyre; Ndertuesit dhe zhvilluesit ne pergjithesi presin clirimin e bllokimit dhe lejimin per te realizuar projektet e tyre sipas disa rregullave te qarta; Arkitektet presin planin qe te hapin vende te reja pune dhe te lejohen te punojne pas shume viteve ku kish nje monopol per arkitekturen ne Prishtinë; Mjedisoret presin qe plani te mbroje zonat e rendesishme mjedisore, por edhe mos lejoje zhvillim ne zonat e ndotura mjedisore, si dhe shpresojne ne rritje sasiore dhe cilesore te vlerave mjedisore ne Prishtinë, perfshi rritjen e siperfaqeve te gjelbra permes krijimit te parqeve te reja rajonale dhe rehabilitimeve mjedisore ne qytet.


PZHUP, perpiqet te zbatoje disa parime dhe modele zhvillimi te pranuar gjeresisht, si psh. Prishtina multicentrike, ku qytetari gjen sherbimet prane vendbanimit te tij dhe nuk ka nevojte te udhetoje per te siguruar sherbimet vec ne qender te qytetit. Plani parashikon zhvillimin e qytetit si nje i tere dhe do perpiqet te perfshije konceptin e formule se menaxhimit te prones ne menyre qe te mos lejohet me zhvillim e veqant.

Plani do te fuqizojte Komunën per te luajtur rol me aktiv mes paleve per te nxitur zhvillimin e qytetit ne bashkepunim me pronaret e trojeve per te ofruar mundesi perfitimi per sherbime publike. Plani gjithashtu rreket te integroje dhe permiresoje situaten aktuale urbane. PZHUP, parasheh nje zhvillim me miqesor me mjedisin, permes krijimit te disa

parqeve periferike, shtimit te siperfaqeve te gjelbra brenda qytetit, rrjetit te plote te levizjes se bicikletave, etj.

PZHUP, eshte ne perputhje me Ligjin e Planifikimit te Hapësinor të Kosovës dhe Rregulloreve perkatese. Ai shoqerohet me relacionin teknik, rregulloret, dhe GIS per te paraqitur modelin e zhvillimit ne menyre sa me sakte dhe te gjeoreferencuar, duke lehtesuar procesin e metejshem te planifikimit te integruar.

Nje grup ekspertesh të mjedisit jane perfshire per te lehtesuar procesin e VSM dhe per te pergatitur raportin perkates. Fillimisht hartimi i VSM ka kaluar permes rishikimit te dokumenteve ekzistues dhe paraqitjes se nje liste me kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin urban te qytetit ne zona te ndjeshme mjedisore. VSM po hartohet njekohesisht PZHUP. Si e tille VSM po kryhet kur alternativat jane ende te hapura. Po konsideron efektet mjedisore te propozimeve strategjike dhe paraqet elementet mjedisore te qenesishem qe kufizojne zhvillimin urban, dhe po ndihmon ne marrjen e vendimeve per planifikimin e Hapësinor ne nivel strategjik.



Harta 22. Planet rregullative të Prishtinës

Pjesëmarrja publike është shumë e rëndësishme për hartimin e PZHUP. Komuna ngriti Grupin Teknik që siguron përfshirjen e ekspertëve me të mirë të fushës, si edhe Grupin Strategjik që mundëson vëmendjen ndaj gjithë spektrit të shqetësimeve qytetare. Qoftë Grupi Teknik dhe qoftë ai Strategjik janë mbledhur në disa dhjetëra takime për të shprehur komente, vërejtje apo sugjerime për hartimin e një PZHUP sa më modern dhe me standarte të BE-se. Përveç këtyre takimeve gjatë procesit të hartimit të Planit, Komuna e Prishtinës ofroi mundësinë që publiku i gjere të shqyrtojë Projekt-Planin për pyetje, vërejtje, komente ose sugjerime. Vetëm pas grumbullimit dhe trajtimit të plotë të secilës prej pyetjeve,

verejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve te publikut Komuna e Prishtinës do paraqese variantin perfundimtar te Planit te PZHU, per miratim ne Asambleja Komunale .

PZHU, eshte proces i plote i planifikimit te territorit pasi shoqerohet me pjesemarrje te gjere publike ne nivelin teknik dhe strategjik, me vleresim strategjik mjedisor(VSM), me plane sektoriale te infrastruktures, me sistem te informacionit gjeografik, planifikim strategjik buxhetor, si dhe mundesine e publikut te gjere te konsultohet dhe te shprehet per projekt-Planin. Si e tille, kjo alternative eshte me e mira .

Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës është dokumenti më i rëndësishëm për të ardhmen e qytetit të Prishtinës. Është Plan i cili merr parasysh që gjeneratat e tjera të munden të realizojnë aspiratat dhe nevojat e tyre. Është jetësim i të gjitha synimeve që dalin nga Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 porse dhe nga Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës, dokumentet e ndryshme strategjike Evropjane për qytetet e qëndrueshme sikurse dhe parimet ndërkombëtare për zhvillim hapësinor të qëndrueshëm.

Me dokumentin e Planit Zhvillimor Urban të Prishtinës, dokumentohet e ardhmja e planifikuar e qytetit të Prishtinës, orientimet e saja zhvillimore zbërthehen në objektiva të matshme dhe specifike, masa dhe veprime për t'u jetësuar dita më ditë me planet dhe programet e shumta të ekzekutivit të saj, të sektorëve të shumtë që punojnë dhe veprojnë në të. Tentohet të arrihen caqet zhvillimore kryesore për një Prishtinë – PORT të Kaltër, port të njohurive, shkëmbimesh kulturore, konkurente dhe atraktive. PZHUP është udhërrëfyes për planet vjetore të ekzekutivit të saj, planet e veprimit për sektorët një e nga një duke pasur parasysh synimin e përbashkët, të përmirësimit të gjendjes së qytetit duke filluar me diagnostikim e problemeve deri tek listimi I masave dhe veprimeve për trajtimin e qëndrueshëm të tyre. Synohet e ardhmja e ndritur e zhvillimeve të qëndrueshme në Prishtinë, për të qenë kryeqytet, i denjë – metropolë, port i njohurive, i shkëmbimit kulturor, atraktiv e konkurent. Me Plan Zhvillimor Urban tentohet që Prishtina të jetë dhe avansojë si:

Qytet i së ardhmes - Për të rinjtë, studentët, fëmijët dhe pleqtë, qytet e saj. Me të planifikuarën e kujdesshëm të qytetit PORT, të kaltërt dhe të integruar me botën, të shoqërisë së njohurive, mjedisit të pastër dhe të gjelbërt, qytetit të larmishëm dhe atraktiv për të jetuar dhe punuar në të, konkurent në regjion.

Qytet – metropolë. Planifikohet me kujdes, duke parasysh të vjetrën e ndritur kulturore dhe historike, identitetin urban të një qyteti tregtar, diplomatik e kulturor, përmes shfrytëzimit racional të hapësirës. Qytet ekonomikisht stabil dhe i suksesshëm, qendër i bizneseve të shumta nacionale dhe ndërkombëtare, qendër e rëndësishme logjistike.

Qytet të Ekonomisë së Njohurive. Qytet studentor, universitar në zhvillim, qytet në shërbim të bizneseve të teknologjië së lartë, i partneritetesh të ndryshme ndërmjet universitetit, institucioneve shkencore, sektorit privat dhe public, qytet që absorbon fondet ndërkombëtare me kapacitetet njerëzore.

Qytet ku Universiteti i Prishtinës së bashku me universitetet private, me hapësirat e tyre ofrojnë mbajtjen e konferencave ndërkombëtare, duke mbështetur kështu turizmin konferenciar.

Qytet -incubator I cili ofron infrastrukturën, platformën “Si - të dish” dhe financat për të mbështetur këto biznese, qofshin ato të dala apo të ofruara nga universiteti, apo nga firmat nacionale ekzistuese. Qytet që mbështet zhvillimet e reja jo vetëm me hotele për të mbështetur komunitetin e biznesit ndërkombëtar, porse dhe hapësira tjera përcjellëse.

Qytet- gjenerator i zhvillimit ekonomik- Me Plan Zhvillimor Urban planifikohet me kujdes për sigurimin e kushteve për zhvillim ekonomik lokal, joshur dhe mbajtur ndërmarrjet aktive në qytet, ofrimin e hapësirave kulturore, tregtare dhe rekreimit e pushimit . Qytet i cili siguron klasës së re profesionale të Kosovës, komunitetit të kthyer kosovar të interesuar për ofrimin e formave të reja për turizëm kulturor. Qytet i artit - Që ofron dhe kultivon art të shumëllojshëm, qendër me hapësira të distrikteve të artit – përderisa objektiv ka riparimet/adaptimet modeste të objekteve të vjetra ekzistuese, për artistë dhe dizajnerë. “Hapësirat e imagjinatës” do jenë ato të cilat do inkurajnë aktivitetet avangarde dhe kulturore përkrah atyre Planifikimi i parimeve të cilat duhet të përfillen

Të ketë qasje të integruar, e cila përfshinë elementet hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për zonën urbane; T’i prijë zhvillimit strategjik brenda zonës urbane dhe të trajtojë çështjet e rëndësishme strategjike për zonën urbane; Plani duhet të parasheh shfrytëzimin racional të burimeve natyrore, hapësirës dhe territorit si dhe të promovoj rehabilitimin e vendbanimeve dhe infrastrukturës; Plani duhet të jetë i shprehur në formën e cila lehtëson monitorimin dhe rishikimin; Plani duhet të merr parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike).

Tabela12: Vleresimi i alternativave të zhvillimit urban

Kritere vleresuese	Alternativa sipas planit të qendrës	Alternativa sipas PZHUP-ës
Zhvillim urban i qendrueshëm	-	+++
Potencial për zhvillim të shpejtë ekonomik	+	++
Zhvillim miqësor me mjedisin	+	++
Ruajtje e biodiversitetit dhe burimeve natyrore	+	++
Infrastruktura që të realizohet me kosto të arsyeshme	-	+
Shendet	+	+
Peisazh	-	-
Aspekte sociale	-	+
Pjesëmarrja publike	-	++

9.3.. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNE ZHVILLIMIN URBAN

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qendrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHUP. Me tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin urban në zona të caktuara të qytetit.

9.4 Parime të Përgjithshme për Planifikim Hapësinor

Parimet e pergjithshme per planifikimin hapesinor jane nje teresi rregullash te bazuara mbi eksperiencat nderkombetare, te cilat shkurtimisht mund te permbledhen ne dhjete pika si meposhte:

- ✓ Nxitja e zhvillimit te qendrueshem;
- ✓ Parandalimi i ndikimit te demshem ne mjedisin natyror;
- ✓ Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, te florës e faunës;
- ✓ Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
- ✓ Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjedisve natyrore;
- ✓ Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan“ ose „përdoruesi paguan“;
- ✓ Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira per mbrojtjen e mjedisit;
- ✓ Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe pergatitjen e sheshit;
- ✓ Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe
- ✓ Bashkëpunim ndërkombëtar.

Ne kuader te hartimit te PZHUP parimet e mesiperme perkthehen ne perpaesite e meposhtme Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës urbane në qendër të qytetit në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes urbane pertej vijave te planifikuara. Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të blloqeve urbane – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës në ngulimet informale.

Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës urbane ekzistuese – akses i intra-urban dhe ndër-nyjor është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit.

Rehabilitimi i lagjeve ekzistuese.

Ruajtja e trashëgimisë historike të qytetit për të ruajtur stilin e Prishtinës së vjetër.

Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve urbane në qytet.

Mundësimi i lindjes së poleve të reja me përdorimeve mikse në vendet e ndërtesave industriale të braktisura.

Zgjerimi i zonës së urbanizuar atje ku kushtet janë të favorshme.

9.5. Kriteret e forta Mjedisore qe Kufizojne Zhvillimin Urban

Keto kategori kriteresh percaktojne zonat e perjashtuara nga zhvillimi urban.

Kriteret e forta perfshijne (i) zona me vlera te vecanta mjedisore (psh. parqet), (ii) zona te rrezikshme per zhvillim, dhe (iii) zona te ndotura te njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike, dhe materie të rrezikshme).

(i) Zonat me vlera te vecanta mjedisore perfshijne:

- Parqet Kombetare
- Parqet e reja periferike

- Parqet/lulishtet rekreative te qytetit

Nuk lejohen ndertimet ne zonat e mesiperme qe bartin vlere te vecanta mjedisore.

(ii) Zonat e rrezikshme per zhvillim perfshijne:

- Shtreterit e lumejve dhe pjeset buferike rreth tyre)

- Zona me pjerresi me te madhe se 15 apo 20%

Ne menyre te ngjashme, nuk lejohen ndertimet ne zonat me pjerresi te madhe pasi ne mjedis argjilor keto ndertime mund te shkaktojne (ose perkeqesojne) situata erodive te kodrave dhe jane nje rrezik publik i perhershem. Ne kete faze te PZHUP, eshte e veshtire te percaktohen me detaje keto zona, por gjate hartimit te Planeve Lokale do duhet te shihen me kujdes per qellime planifikimi .

(iii) Zona te ndotura te njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. mbetje kimike) perfshijne:

- Vend depozitime mbeturina te rrezikshme

Para se gjithash, keto zona duhet te jene objekt i studimeve per vlersimin e situates mjedisore mbi bazen e te cilit do te mund te gjykohet mbi nivelin e ndotjes se tokes dhe masat eventuale qe duhen nderrmare per rehabilitimim, perpara se objekti i studimit te zhvillohet per funksione industriale, rezidenciale, sportive, rekreative, etj.

Ne kete faze te PZHUP-it, eshte e veshtire te percaktohen me detaje keto zona, por gjate hartimit te Planeve te detajuara vendore do duhet te shihen me kujdes keto elemete.

9.6. Kriteria Peisazhike

Kriteret peisazhike jane me te veshtire per te percaktuar pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar ne bashkepunim dhe pajtuesmeri me komunat perreth Prishtinës. Zona me vlere te larta peisazhike ne te cilat nuk duhet te lejohet ndertimi perfshijne:

- Kreshtat e maleve dhe kodrave qe rrethojne Prishtinën

- Shpatet e sipërme te kodrave qe duken nga Prishtina

- Zonat pyjore dhe rekreative

- Koridoret pamore te rrugëve (psh. mos pengohet pamja e rrugëve drejt qendres/sheshit)

10. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

10.1. Plani dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit në Prishtinë

PZHUP, është rezultat i evidentimit, vlerësimit, dhe prioritizimit të nevojave strategjike zhvillimore sociale-mjedisore të qytetit dhe komunitetit të tij nga ana e Grupit Strategjik të Planit Urbanistik. PZHUP, ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e këtyre objektivave strategjike në një sistem planifikimi urban. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i një plani të detajuar zonimi dhe kode me instrumente të veçanta zhvillimi urban, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të

veprimet me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit urban në zonën e përfshirë në studim.

Plani merr në konsideratë dhe përgjithësisht është në përputhje me planet e ndryshme të infrastrukturës, si dhe në linjë edhe me shtyllat kryesore të zhvillimit të Planeve Sektoriale ende në fazën e fundit të përfundimit, përkatësisht planisektorial i mbetjeve, i infrastrukturës rrugore, i infrastrukturës së ujërave të përdorura, i furnizimit me ujë, i trajtimit të mbetjeve urbane,

10.1 Analiza e Plotë e Ndikimit në Mjedis të PZHUP

Ndikimi i problemeve mjedisore në Prishtinë nuk është përkthyer ende në efekte ekonomike apo shëndetësore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një check-list e kriterëve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse PZHUP e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nepermjet shenjave si mëposhte:

Atje ku PZHUP jep përgjigje të plotë problemit është vendosur treguesi √;

Nëse PZHUP e ka trajtuar problemin, por ka nevojë për masa të mëtejshme vendoset treguesi ?;

Nëse ka problem i cili duhet të trajtohet nga PZHUP, vendoset treguesi X.

Tabela nr 13 : Konsiderata Mjedisore e PZHUP-ës

Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në PZHUP?	Si është trajtuar problemi në PZHUP?	Treguesi
Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Përfshihen në seksionet e mëposhtme.	√
	Po	Një faktin se kjo është ende e vështirë	√

Problemet e evolucionit demografik		për t'u parashikuar saktë, pasi të dhënat kundërshtojnë njëra-tjetrën. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet ,për t'i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme.	
Skenarët e evolucionit demografik	Po	Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet deri 2025. Mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	✓
Planifikimi Urban dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Njeh nevojën për pranimin e zhvillimit aktual,përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore	✓
Kapacitetet mjedisore në zonat e propozuara për zhvillim	Po	Vlerësohet se Prishtina ka një gjurmë të lartë të cenimit ekologjik, duke e tejkaluar kapacitetin e saj mjedisor. Zonat e mëdha të propozuara për zhvillim urban apo ekonomik kanë qenë më parë të kategorisë “tokë bujqësore” të konvertuara vonë në zona informale, siç është rasti i shtrirjes së Prishtinës drejt Veriut dhe Lindjes .	Kapacitetet mjedisore në zonat e propozuara për zhvillim
Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja të çlodhëse	Po	Njeh problemin e mungesës së tokës dhe propozon mbrojtjen e liqeneve dhe parqeve rreth qytetit duke krijuar një Kurorë të gjelbër të përbërë nga disa liqene dhe sisteme kodrinore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe liqenet , te kenë kufijt e tyre ndersa Parqet të kenë Planet e Menaxhimit lidhur me zhvillimet brenda këtyre kufijve.	?
Zhvillimi i parqeve urbanë të reja brenda qytetit	Po	Njeh problemin e mungesës së tokës brenda zonës së studimit dhe propozon një plan masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me plane veprimi për çdo kategori zonash.	?
Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe.	?
	Po	Trajtohen në mënyrë specifike, sepse	?

Rrëshqitjet e tokës		jepen standartet kufizuese për pjerrësitë e mëdha.	
Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjente në rast të rrezikut	?
Zjarret	Jo	Duhet trajtuar problemi i dendësisë së ndërtimit në mënyrë që të jenë të menaxhueshme rastet e rënies aksidentale të zjarreve në banesa.	?
Energjia & Telekomunikacioni	Po	Po	✓
Energjia (efiçensa dhe energjitë e ripërtëritshme)	Jo	Mund të bënte sugjerime për projekte ndërtimi më efikënte nga pikëpamja e konstruksioneve që kursejnë energjinë. Mund të sugjeronte dhe vendoste koncepte urbanistike dhe arkitektonike që promovojnë energjitë e ripërtëritshme në qytet.	X
Rrugët	Po	Po, bën rekomandime të detajuara në lidhje me hierarkinë e rrugëve. Zonat e propozuara për përdorim të kufizuar janë shumë të vogla në plan dhe mund të zgjerohen me qëllim që të mundësojë aktivitete gjelbëruese dhe të lejojë ndërtimin e rrugës atje ku ka tokë të disponueshme, pra që nuk duhet të blihet dhe ku kushtet e tokës të jenë të tilla që të reduktojnë kostot e ndërtimit..	?
Qarkullimi i trafikut	Po	Synon të bëjë shpërndarjen e trafikut dhe të lehtësojë përqendrimin e tij në qendrën e qytetit.	✓
Parkimi	Po	Propozim i detajuar i përfshirë në kodin e zonimit. Megjithatë njihet problemi i mungesës së vendeve të parkimit në qendrën e qytetit.	?
Siguria në rrugë	Po	Hierarkia më e mirë e rrugëve do të ulë numrin e aksidenteve. Nuk trajtohet menaxhimi i trafikut.	?

Transporti publik	Po	Duhet të ishte prioritet, por njeh rëndësinë që ende kanë automjetet private. Ka nevojë për më tepër lobim dhe investime. Propozon një transport të shumëllojshëm dhe qarkullim më të sigurtë të këmbësorëve në qytet.	✓
Transporti alternativ	Po	Njeh nevojën për promovimin e mënyrave alternative të transportit. Veçanërisht planifikon adoptimin e një rrjeti korsi biçikletash në zonën urbane ekzistuese. Por duhet bërë më shumë në këtë drejtim. PZHUP duhet të vendosë kritere të tilla që asnjë rrugë e re e ndërtuar rishtaz apo e rikonstruktuar mos të bëhet pa pasur edhe korsinë përkatëse të biçikletave në rrugë apo në trotuar sipas rastit dhe mundësisë. Vetëm kriteret detyruese për infrastrukturën mund të krijojnë mundësinë për një rrjet korsish biçikletash në Prishtinë	?
Cilësia e Ajrit	Po	Vetëm brenda planeve për trafikun. Nuk ka si synim të japë propozime për përmirësimin e teknikave të ndërtimit të ndërtesave apo të infrastrukturës, që do të sillnin uljen e nivelit të pluhurit. Nuk vendos kritere për mbulimin me bimësi të vazhduar të zonave të gjelbra ekzistuese apo të reja të qytetit, me qëllim për të shmangur lëshimin e PM në ajër.	?
Cilësia e Ujërave Sipërfaqësorë	Po	Lidhet me grumbullimin e trajtimin e ujërave të përdorura	?
Çështje ndërkufitare	Po	Jo, nuk përbëjnë problem për momentin.	✓
Konsiderata për ekologjinë dhe biodiversitetin	Pjesërisht	Nuk përfshihen në raport, por ngadalësimi i rritjes urbane dhe mbrojtja e ujërave e pyjeve do të ndihmonin në perteritjen dhe ruajtjen e tyre.	?
Plani Zhvillimor	Po	Përgjithësisht po	✓

Strategjik i Prishtinë			
Standardet Mjedisore	Po	Pjesërisht për përdorimin e tokës. Përveç përdorimit të tokës për zona të gjelbra, standardet mjedisore nuk kërkohen në plan por ndërkohë nuk ka as konflikt.	✓
Standardet ndërkombëtare	Po	Të mjaftueshme për parametrat e planit dhe nuk ka konflikt.	✓
Legjislacioni mbi Mjedisin	Po	Po	✓
Monitorimi dhe vlerësimi i planit të zbatimit	Po	Monitorimi mbulohet nga rregulloret e ndërtimit. Vlerësimi nuk përfshihet	?
Treguesit (paraparakë)	Po	Ofron tregues indikativë ose norma. Nuk është bërë ndonjë studim paraparak, paraqet vështirësi për t'u kryer	?

10.2. Masat e Nevojshme në PZHUP për Mbrojtjen e Mjedisit

Bazuar në analizën e mësipërme ky seksion bën rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me ✓ nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mësipërme përmban një përmbledhje të të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën plani u jep përgjigje secilit prej tyre. Megjithatë, një nga pikat e tabelës së mësipërme që ka të bëjë me skenarët dhe parashikimet e rritjes së popullsisë, megjithëse është trajtuar, ka nevojë për diskutim të mëtejshëm.

11. MONITORIMI

Suksesi i PZHU-së dhe VSM përkatëse do percaktohen nga respektimi i kushteve, rregullave dhe objektivave të shpallura dhe të aprovuara. Në mënyrë të veçantë, puna do vijojë me hartimin e Planeve dhe projekteve tjera që do të detajojnë dhe qartësojnë me tej elementet kryesore të cilat paraqiten përmbledhtas në PZHUP-së. Si të tilla, duhet që keto Plane dhe projekte të ndjekin frymen dhe parimet e PZHUP-së e të mos cenojnë rregullat përkatëse. Monitorimi i respektimit të PZHUP-së edhe gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve tjera do jetë përgjegjësi dhe detyrim i komunës së Prishtinës.

Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e "Vlerësimit Strategjik Mjedisor", kerkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose

shendetesore të zbatimit të planit apo programit, në menyrë që të identifkohen në fazë të hereshme pasojat negative të paparshikuara dhe me qellim marjen e masave rregulluese.

E njejta kerkese eshte parashikuar ne nenin 10 te Direktives se BE per VSM-n. Sipas po kesaj direktive, me qellim qe te shmangen dublikimet ne procesin e monitorimit, mund te perdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i pershtatshem.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AMMK – Agjensia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, e cila zbaton Monitorimin në bashkepunim me institucionet perkatese të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal . Me qellim që PZHUP-të të zbatohen me efektivitet dhe te realizohen objektivat dhe synimet qe janë percaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe sic e parashtuam edhe me siper; eshte kerkese ligjore, që tëmonitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative ne mjedis.

Për të qene sa me racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do ti referohemi atyre tregueseve qe kane rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtien e mjedisit d he kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutese tëPZHK-së. Plani Monitorimit permbledh shumë treguesë që perfaqësojnë një numer të konsiderueshem të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kesaj ndermarrje kerkon angazhimin e mjaftë institucioneve te cilet duhet te bashkërendojne aktivitet perkates monitoruese nen drejtimin e Agjensise Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës

Mbeshtetur ne Ligjin për mbrojtien e mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Prishtinës ka per detyre të kryej monitorimin e aktiviteve qe kryen në kuadrin e zbatimit te PZhU-së. Këtu perfshihen qoftë Planet ,projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZHUP-së në Plane rregulluese per vendbanimet policentrike, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Prishtinës. ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe per rrjedhojë, nuk mund te mbuloje me kapacitetet dhe burimet e saj njerezore dhe financiare te gjithë kete veprimtari. Megjithate ajo, duke angazhuar Drejtorin e planifikimit dhe Mjedisit dhe struktura te tjera në vartesi te saj mund te kryej nje pjese të programit të monitorimit si cilesine e ndertimeve, ecurine e pyllzimit dhe zhvillimit të pyjeve,zgjerimit të parqeve dhe siperfaqeve te gjelbra, ecurine nderimit te rrugeve të reja perfshire ato për qarkullimin me bicikleta dhe dhe te tjere indikator qe jane paraqitur ne programin e monitorimit te PZHUP-së.

Rezultatet e monitorimit, komuna e Prishtinës. sipas ligjit për VSM-n, duhet ti publikoj ne menyre

periodike çdo vit. Per elementet e tjere te mjedisit duhet te procedohet sipas ligjeve që mbulojn

fushen VSM,VNM per monitorimin dhe rezultatet ti percillen komunës së Prishtinës dhe Agjensise për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor ti publikoj ne kuader te Raportit Vjetore per Gjendjen e Mjedisit ne Republiken e Kosovës.

Tabela 14. Monitorimi mjedisore institucional

Mjedisi	Objektivat	Synimi	Indikatoret	Raportimi	Institucioni Përgjegjës
Ajri	1.Permiresimi i	1. Ulja e niveli te ndotjes se ajrit	1. Arritja e vlerave te standardit per cilesin	1. Raportim 1 here ne 6	AMMK dhe Komuna e

	cilesise se ajrit 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelt te zhurmave ne zonat problematike te Komunes 4. Aplikimi ne banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtje akustike	per: NO2; NOx; CO2, PM10; PM2.5; 2. Gjatesia e rrugeve te asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmes gjate dites dhe nates 4. Ulja e niveli te zhurmave ne mjediste e banimit	e ajrit lidhur me tregusit mbi norme 2. Gjatesia e rrugeve te asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmes gjate dites dhe nates 4. Ulja e niveli te zhurmave ne mjediste e banimit	Muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 4. Raportim 1 here ne vit	Prishtinë 2. komuna e Prishtinës 3. komuna e Prishtinës 4. komuna e Prishtinës
Uji	Cilesia e ujrave sip.ne perputhje me kerkesat e legjislacionit te Kosoves dhe Direktives kuadre per ujin te BE	1.Shmangia e shkarkimeve te ujrave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i hudhjeve te mbeturinave ne lumenj. me qellim ruajtien e niveleve minimal te ndotjes	1a. Vellimi i ujrave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vellimi i ujrave mbi normat e lejuara qe shkarkohen Lumenje; m3. 2. Siperfaqja e ndotjes (m2) vllimi i mbeturinave (kg ose m3) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i sakte i mbeturinave te forta te gjetura ne shtrat te lumit	1.Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	1.Komuna e Prishtinës, AMMK. 2. Komuna e Prishtinës, AMMK.
Faktoret klimatik	Kursimi i energjise	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat 2. Promovimi i paneleve diellor per gjenerim energjie ne ndertesat residenciale dhe sociale dhe energjia e	1. Siperfaqja e objekteve (m2) me izolim adekuat 2. Siperfaqja (m2)e paneleve te instaluar dhe siperfaqja e ngrohur nga energjia e eres (m2)	1. 1 here ne Vit 1. 1 here ne vit	1.Komuna e Prishtinës 1.Komuna e Prishtinës

		krijuar nga era			
Biodiversiteti	Identifikimi dhe krijimi i habitetve te reja, dhe korridoreve te gjelber	1. Zgjerimi dhe permirsimi i parkut "Regjional Germia" dhe Krijimi i parqeve tokesor te reja neper disa vendbanim 2. Krijimi i mjedisve te gjelbra ne Vendbanime 3.Rehabilitimi i siperfaqeve te pyjore ne zonat pyjore dhe ato te gjelbra ne zonat e banimit 4. Mbjellja e druve,pemeve dhe shkurreve dekorative pergjate rrugeve regjionale, shtratit te lumejve 5. Krijimi i korridoreve te gjelbra dhe tampon zonave	1. Siperfaqet e reja te krijuara, sip. m2 2. Siperfaqe te reja, m2 3.Siperfaqet te rehabilituara, m2 4. Numri i druve,pemeve dhe shkurreve dekorativete mbjella 5. Siperfaqe te kthyer ne zone te gjelber, pjese e koridorrit dhe tampon zona; m2	1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim 1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit	1. Komuna e Prishtinës dhe MMPH 2. Komuna e Prishtinës dhe MMPH 3. Komuna e Prishtinës dhe MMPH 4. Komuna e Prishtinës dhe MMPH & MBPZHR 5. komuna e Prishtinës dhe MMPH & MBPZHR dhe Ministria e Infrastruktures
Mbeturinat	3)Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi qendrueshem i tyre b) Shnderrimi i pikave te nxehta mjedisore ne siperfaqe te gjelbra/parqe ose zona residenciale	a.1. Pakesimi ne burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere per ndarjen ne burim te mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne territoret industriale mbyllura	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara. a.2. Numri i residenteve qe mbulohen nga sherbimi me kontenier b.1. m2te rehabilituara ose inkapsuluara	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. Komuna e Prishtinës, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AMMK a.2 komuna e Prishtinës ,kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht b.1. komuna e Prishtinës, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPH gjegjesisht AMMK
	1.Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve	1. Shtimi i hapsirave te reja dhe numurit te pemeve e shkurreve.	1. Siperfaqet ne m2 dhe numuri i pemeve te mbjella	1. Nje here ne vit 2. Nje here	1. Komuna e Prishtinës 2. Komuna e Prishtinës

Peizazhi,pyjet dhe toka	peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat per rreth vendbanimeve 3. Ripërdorimi i tokave te ndotura 4.Mirëmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5.Kultivimi i pyjeve te reja	2. Dhenie e statusi mbrojtje dhe hartimi i nje plani manaxhimi mjedisor i ktyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxeha mjedisore) dhe venia ne eficiense per zona te gjelbera/parqe ose rezidenciale 4.Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllezimi i hapësirave te zhveshura	2.Progresi i zbatimit te planit 3. Siperfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m2) dhe e vene ne perdorim sipas PZHK. 4. Siperfaqe toke se zhvilluar pyjore (ha) 4. Siperfaqe toke se re pyjore (ha)	ne vit 3. Nje here ne vit 4. Nje here ne vit 5. Nje here ne vit	3. Komuna e Prishtinës 4. Komuna e Prishtinës dhe MBPZHR 5. Komuna e Prishtinës dhe MBPZHR
Trashegimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe Shtimi dhe mbrojtja e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe	Rehabilitimi, mirembajtja dhe ruajtja e objekteve te trashegimise kulturore	1.Numri i objekteve/ndertesave me status mbrojtjes 2. Numri i objekteve/ndertesave te restauruara	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Prishtinës Instituti per mbrojtjen e Monumenteve ? ende i pa themeluar por pritet 2. Komuna e Prishtinës Instituti per mbrojtjen e Monumenteve(Pritet të themelohet).
Rrugët dhe Transporti	Reduktimi i intesitetit te trafikut nepermjet promovimit te transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhe	1.Zgjerimi i rrjetit rrugor per trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive per bicikleta 3. Ndertimi i rrugëve te reja me hapsira te pershtatshme trotuaresh (perfshire korsite e bicikletave). Zgjerimi i trotuaresh gjate rehabilitimit te rrugëve ekzistuese. 4.	1. Km rrugë shtese qe mbulohe nga trafiku urban. 2. Km korsi shtese per levizje me bicikleta. Numri i bicikletave ne qarkullim. 3. Km rrugë te reja dhe te rehabilituara. m2trotuarre dhe korsi bicikletash te shtuara.	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Prishtinës. „Ministria e infrastruktures dhe MMPH 2. Komuna e Prishtinës. . 3. Komuna e Prishtinës. „Ministria e infrastruktures dhe MMPH 4. Komuna e Prishtinës.

		Rehabilitim/asfaltimi i rrugeve lokale	4. Km rruge lokale te rehabilituara ose/dhe asfaltuara		
Shendeti banoreve	Promovimi per krijimin e nje komune te qendrueshem dhe te shendetshme	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem konform stand. te BE ujrart siperfaqsove dhe nentokesore destinuara per uje te pishem 2. Cilesia e ujit te pishem konform standardit 3. Dendesia e popullsisë e qendrushme ne vendbanimet me trend te rritjes se popullsisë	1. Cilesia e burimeve te ujit te pishem, kundrejt standardit te BE. 2. Cilesia e ujit te pishem ne perputhje me standardin 3. Dendesia mestare per keto vendbanime	1. Rap.Vjetor 2. Rap.Vejtor 3. Rap.Vjetor	1. Drejt. Sherbimeve Publike Prishtinë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor. 2. Drejt. Sherbimeve Publike Prishtinë 3. komuna e Prishtinë

12. PERFUNDIME

Hartimi dhe zbatimi rigoroz i PZHUP -së në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Ai do të orientojë rritjen e mundëshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Prishtinës me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth ktyre vendbanimeve aktuale në komunën e Prishtinës. Ai gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme. PZHU-ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribojë në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, si dhe rritjen e hapësirave të reja gjelbëruese duke respektuar edhe standardet e BE-se.

Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikase të tokës.

Ndër alternativat e paraqitura të mundëshme, zhvillimi i deri tanishëm në aspektin e problematikes së zonave ndërtimore, shoqerore dhe mjedisore të Prishtinës nuk ka pasur një zhvillim të qëndrueshem.

Ai gjithashtu shoqerohet me pjesëmarrje të gjere publike në nivelin teknik dhe strategjik, me VSM, me disa strategji e plane të më hershme, me GIS, Vlersim të Kapaciteteve Investive, si dhe mundesine e publikut të gjere të konsultohet dhe te shprehet per projekt-Planin. PZHUP-së lejon mundesine e qartesimit dhe detajimit me te hollesishem gjate hartimit te Planeve dhe projekteve tjera lokale (planeve rregulluese). Si e tille, alternativa e paraparë me PZHUP vlersohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera .

Jane pasur parasysh parimet e pergjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat nderkombetare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejsazhere, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimarrje, etj.

Zbatimi praktik i parimeve të pergjithshme në rastin e PZHUP-së nxjerr disa përparesi si psh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojn ndërtimin, strukturimi dhe rishtrukturuimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë historike, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

PZHUP-ja përpiqet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuar gjerësisht përfshi:

Komuna e Prishtinës komunë e cila perballon nevojat për banim të banorëve të saj;

Komuna e Prishtinës komunë e pastër dhe me një popullsi të shëndoshë;

Komuna e Prishtinës komunë policentrike

Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe zhvillimin

,krijimin e pyjeve, koridoreve ekologjike dhe tampon zonave në Prishtinë;

Zgjerim të rrugëve por dhe nxitjes së ecjes kembësore dhe me bicikleta;

Permiresim transportit publik (përmiresim i shërbimit të autobusëve);

Zgjerim i vendbanimeve me trende pozitive në drejtimin të tokave me plleshmëri më të dobët.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në Prishtinë, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmiresim icilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbra në Prishtinë

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbra në Prishtinë:

P1. Themelimi i Degës së Institutit për Mbrojtjen e Natyrës (në varësi nga Instituti i Mbrojtjes së Natyrës në nivelin qendror) me seli në Prishtinë e në shërbim të arrijtjeve (mundësimi që qyteti i Prishtinës të jetë dhe më i gjelbër, më i pastër, më miqësor për qytetarët e saj me kualitetin e lartë jetësor; organ i cili hulumton llojet e bimësisë, menaxhon mjedisin e pandërtuar, bën ujitjen dhe mbjelljen e mirëmbajtjen; rregullimin e sistemit të ujitjes së kontrolluar nga distance;

M2. Lirimi i hapësirave të rrethuara të qytetit, për të mundësuar frymimin e lirshëm të qytetit;

P3. Projekt – konkurs për “Hapësira publike dhe lidhjen e tyre këmbësorike në Prishtinë”. Për përjetim të qytetit

në këmbë, hapësirave publike të gjelbërta, shesheve publike urbane në qytet; mundësimin e të qenit më funksional të hapësirave publike sipas parimeve në botë për shumëllojshmëri të funksioneve, të kualitetit më të lartë të përjetimit të hapësirës gjatë cdo sezone, të hijëzuara dhe përshtatshme në kushte të ndryshme atmosferike; për rekreim dhe shfrytëzim si nga pensionistët, fëmijët, nënat me fëmijë, studentët etj;

P4. Mbështetje në promovimin e “Transportit të Jo Motorizuar në Prishtinë” - me joshje të të rinjve në sport dhe rekreim dhe promovimin e shëndetit public;

P5. Projekt- konkurs për Iniciativa të ndryshme për “Shfrytëzim të autostradave nëpër qytet dhe sheshe për rekreime javore e mujore, arritja e të qenit Prishtina - pionere e zbatimi të ideve të reja në botë për shfrytëzimin e autostradave si sheshe për funksione dhe ngjarje të ndryshme rekreative;

P6. Projekt – konkurs për ridizajnim të sheshit “Adem Jashari” në “Shesh të Artit dhe Pagues”; në të cilën do të jetë në funksion të artit e të kulturës prishtinase, të jetë hapësirë e promovimit dhe stimulimit të krijimtarëve të rinj artistë në skulpturë, porse dhe të shndërrohet në shesh të famës së kontribuesve për lirinë e Kosovës;

P7. Projekt- konkurs për ridizajnim dhe shfrytëzim racional të “Parkut Memorial të dëshmorëve-pranë varrit Ibrahim Rugova, si park për rekreim dhe pushim;

P8. Projekt – konkurs për planifikim dhe ridizajnim të “Parku të Varrezave të Prishtinës”;

P9. Projekt – konkurs për planifikim dhe ridizajnim të rrëpinave dhe deponive të mbeturinave në qytet të Prishtinës në hapësira të gjelbërta dhe të mbjellura e të përkujdesura; Shndërimi në parqe të gjelbërta dhe të shfrytëzueshme për rekreim; (Tek tjegullorja dhe tek lagja Velania)

P10. Projekt – konkurs për ridizajnim dhe shfrytëzim tërë sezonal të Liqenit të Gërmisë (terrene skateboard , patinazh, lojëra bejzbolli, lojëra hendbolli, volejballi etj) për fëmijë dhe të rinjë; Ky “Park i Liqenit të Gërmisë” do të duhej me këtë rast të merrej parasysh të lidhej me parkun Taukbashqë>>> Parkun e Qytetit>>> konviktet e studentëve – në këmbë përmes shtigjeve për këmbësorë dhe bicikleta; Të mundësohet që rripi apo brezi I gjelbërt nga Taukbashqja deri tek Gërmia të lirohet nga ndërtimet private dhe e cila zonë më parë ishte publike.

P11. Projekt – konkurs për planifikimin e terreneve të hapura dhe të mbyllura të sportit dhe të rekreimit në qytet, sipas standardeve evropjane...!

P12. Projekt – konkurs për ndalimin e qarkullimit motoristik në parkun Gërmia, për të përdorë alternativa tjera jomotoristike apo dhe mjete tjera hibridë dhe jondotës të transportit public- autobusë dhe tren elektrik, të cilat do të dëshmoreshin dhe mëpastaj do të aplikoheshin dhe [ër më tepër dhe në shesh të Prishtinës etj

PZHUP parashikon zhvillimin e komunës së Prishtinës si policentrike dhe kompaktënë vendbanimet e sajë, duke trajtuar të gjitha elementet deri tek banimi. Në këtë fazë, duke qenë PZHUP, do jepen zonat, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e parashikuara për të përgjithëshme dhe veçanta për vendbanimet dhe zonat tjera, ndersa puna do vijojë me Planet rregulluese, projekte dhe zhvillime tjera për të detajuar zhvillimin. Plani do perpiqet të përfshijë konceptin e formulës së menaxhimit të pronës.

Plani do të jetë një mekanizëm që ofron zgjidhje për zhvillimin e komunës. PZHK-së duhet të fuqizojë komunën të luajë rol me aktiv mes paleve për të ofruar mundësi për të mos mbetur peng i mosmarrveshjeve mes paleve.

VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga PZHK-ja. Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal janë (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, (2) kritere të trashëgimisë kulturore, (3) kritere peisazhike dhe (4) kritere inxhinierike dhe të infrastruktures.

Kriteret e forta mjedisore-shëndetsore përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal.

Kriteret e forta përfshijnë (i) zona me vlera të vecanta mjedisore (psh. parqet), (ii) zona të rrezikshme për zhvillim (pjerresi të medha, shtrat lumi, etj.) dhe (iii) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. zona të ndotura me mbetje kimike, akumulatore,

pulari, etj.). Nuk lejohet germimi ne zonat “hot spot” mjedisore pasi zhvillimi i zones mund te cenoje integritetin e shtresave te ujrave nentokesore dhe ndotja me kimikate te rrezikshme mund te kaloje ne shtresat nentokesore dhe mund te shkaktojne semundje kancerogjene deri ne largesi te medha prej zonës në fjalë. Në zonat e ndotura rekomandohet inkapsulimi i tyre duke i kthyer ne zone te gjelbra me vlerë rekreative për qytetin.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatimit të PZHUP. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cënuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Monitorim i zbatimit te PZHUP-së dhe parametrave mjedisore te tij do jetë kyc i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për cdo element mjedisor.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të PZHUP-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit dhe burimeve natyrore, por puna nuk përfundon këtu. Hartimi i Planeve rregulluese dhe projekteve tjera do duhet të sigurojë përfshirjen e faktorëve mjedisorë gjatë detajimit të planeve ne nivel më të ulët gjatë zbatimit te PZHUP-së. Përvec pikave të renditura më sipër, ka nevojë që hartimi i Planeve rregulluese të shërbejë për të përcaktuar dhe siguruar kufijtë e zonave të gjelbra, si edhe për të identifikuar dhe zhvilluar hapësira të vogla çlodhëse dhe rekreative sportive në vendbanime.

Së fundmi – por jo nga rëndësia – duhet të punohet vazhdimisht dha nga të gjitha institucionet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kontrollit mjedisor. Ngritja e mekanizmave të till në nivel komunal do duhej të ishte vetëm një hap i parë në drejtimin e duhur.

Çështjet me prioritet

Edhe pse shumë nga çështjet mjedisore në vazhdim janë trajtuar në forma të ndryshme në PZhU, megjithatë, bazuar në gjendjen ekzistuese faktike dhe dinamiken e zhvillimit, si çështje me prioritet që kërkojnë adresim sa më të shpejt, në kuadër të VSM, vlerësohet të jenë:

- Identifikimi i zonave me faktorë të rrezikut (hartat e erozionit, rrëshqitjeve, harta sizmike, e vërshimeve, si dhe ndotjeve ekzistuese eventuale), Shif harten 1,2 ,3) identifikimi i zonave të cilat duhet mbrojtur në lidhje me mbrojtjen e resurseve të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor dhe zonave të mbrojtura, si dhe identifikimin e zonave me vlera për nga trashëgimia kulturore.(Shif harten 1,2)
- Shqyrtimi i mundësive të ndërtimit të unazës së brendshme me sa më pak ndikim në pjesën lindore të qytetit (malet/shpatet dhe parku i Gërmis). Ky segment verilindor-lindor, të zhvendoset sa më afër të jetë e mundshme ka brendia e qytetit!)

- Arsyeshmëria për nevojën e ndërtimit të unazës së jashtme dhe atë në tërësinë e saj. Pse nuk mund ta luan atë rol unaza e brendshme!?
- Shqyrtimi i lokacionit të mundshëm për deponimin e mbeturinave komunale
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza

Fig.1. Harta me Kriteria te Forta Mjedisore (zona me vlera te veqanta mjedisore dhe shkalla e Erozionit)




Fig.2. Harta e klasave te tokes(bonitetit) dhe Pika e nxehta(te ndotura)




Fig.3 Harta sezmike e Kosoves



13. LITERATURA

- ❖ Beder S. 2006. *Environmental principles and policies. An interdisciplinary introduction*, Earthscan.
- ❖ Casamonti M., Giberti M. 2012. *Abitare la comunità. Strategie di intervento nei sistemi urbani spontanei*. Forma edizioni, Poggibosi (Italy).
- ❖ American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. *Standartet e planifikimit dhe projektimit urban*, Ufo University Press.
- ❖ IC consulenten / Witteveen+Bos / SE consulting engineers. 2008. *Identification and Prioritization of Environmental Hot Spots. Report prepared with UNDP asistance*.
- ❖ Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches.
- ❖ Qendra Rajonale e Mjedisit. REC- zyra në Kosovë
- ❖ AMMK- Raportet Zyrtare mbi Gjendjen e Mjedisit- ammk-rks.org
- ❖ Renewable & Appropriate Energy Laboratory Energy & Resources Group , University of California, (2012). *Sustainable Energy Options for Kosovo. An analysis of resource availability and cost* . Berkeley, 2012
- ❖ [WWW document] URL:
<http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>
- ❖ European Commission (2010). *Communication from the Commission EUROPE 2020. A strategy for smart, sustainable and inclusive growth*. COM(2010) 2020 final. Brussels.

- ❖ [WWW document] URL:
<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>
- ❖ Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). *Strategic environmental assessment: a sourcebook and reference guide to international experience*. Earthscan, USA
- ❖ Marsden, S. (2008). *Strategic Environmental Assessment in International and European Law*. Earthscan, USA
- ❖ Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). *Strategjia për Mjedisin 2013-2022*. Prishtinë, 2013
- ❖ Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). *Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022*. Prishtinë, 2013
- ❖ Legjislacioni Mjedisor – mmph-rks.org
- ❖ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit (2011). *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet 2011 – 2020*. Prishtinë.
- ❖ Nushi, L. (2011). *Përmirësimet për Sistemin e Planifikimit Hapësinor të Kosovës. Projekti Capstone. Tema e masterit, AUK & RIT*. [dokumenti WWW] URL:
https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13686/LuanNushi_CapstoneProject_Report_5-06-2011.pdf?sequence=6

- ❖ *The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). Strategic Environmental Analysis of Kosovo. REC field office in Kosovo, Pristina. [WWW document] URL: <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>*
- ❖ *Therivel, R.; Wilson, E.; Thompson, S.; Heaney, D. and D. Pritchard (1992) . Strategic Environmental Assessment. London, Earthscan.*
- ❖ *United Nations Economic Commission for Europe. (2008) Spatial Planning. Key Instrument for Development and Effective Governance. [WWW document] URL: http://www.unece.org/fileadmin/DAM/hlm/documents/Publications/spatial_planning_e.pdf*
- ❖ *United Nations General Assembly (2000). United Nations Millennium Declaration*
- ❖ *[WWW document] URL: <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.pdf>*
- ❖ *World Bank (2012). Kosovo Country Environmental Analysis. Cost Assessment of Environmental Degradation, Institutional Review and Public Environmental Expenditure Review.*
- ❖ *WWW document] URL: <http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA.pdf>*
- ❖ *Legal Acts: European Parliament/Council SEA Directive, 2001. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT>*
- ❖ *European Parliament/Council Habitats Directive, 1992. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992L0043:EN:NOT>*
- ❖ *European Parliament/Council Water Framework Directive, 2000. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0060:EN:NOT>*
- ❖ *The UNECE Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters (Aarhus Convention), 1998. [WWW document] URL: <http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>*
- ❖ *The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Espoo Convention), 1991. [WWW document] URL: http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html*
- ❖ *UNECE Protocol on Strategic Environmental Assessment to the Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Kiev Protocol), 2003. [WWW document] URL: http://www.unece.org/env/eia/about/sea_text.html*
- ❖ *Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor. [dokumenti WWW] URL:*
- ❖ *Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit. [dokumenti WWW] URL*
- ❖ *Legjislacioni Mjedisor - <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf>*

Shtojca 1: Lista e Shkurtimeve

- ❖ PZHUP – Plani Zhvillimor Urbanistik I Prishtinës
- ❖ PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
- ❖ MMPH- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- ❖ AKMM - Agjencia Kosovarë për Mbrojtjen e Mjedisit
- ❖ BE - Bashkimi Evropian
- ❖ GIS - Sistemit i Informacionit Gjeografik
- ❖ OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë
- ❖ OJQ - Organizata Jo Qeveritare
- ❖ TeR - Termat e Referencës
- ❖ UNDP - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
- ❖ UNEP - Programi për Mjedis i Kombeve të Bashkuara
- ❖ VNM - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
- ❖ VSM - Vlerësim Strategjik Mjedisor
- ❖ LMM- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
- ❖ LPH – Ligji për Planifikim Hapësinor në nivel vendi
- ❖ PKIN - Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes
- ❖ UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Koosvë
- ❖ DPH – Departamenti i Planifikimit Hapësinor
- ❖ IPH – Instituti i Planifikimit Hapësinor
- ❖ PLVM – Planet Lakale të Veprimit në Mjedis
- ❖ PPU- Plani i Përgjithshëm Urbanistik